



**PROFETI MUHAMED,
PROFETI I PAQES DHE I DASHURISË**

Tiranë, 2021

Titulli: **Profeti Muhamed, Profeti i paqes dhe i dashurisë**

Autori: **Haxhi Shejkh Vullnet Merja**

Redaktoi: **Jerida Kulla**

Korrekttoi: **Vjollca Karaj**

Përgatiti për shtyp: **Sabrie Feza**

Kopertina: **Isra Merja**

Botoi: **Shoqata Flladi – Tiranë, 2021**



PROFETI MUHAMED, PROFETI I PAQES DHE I DASHURISË

Mesazhi që solli Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*) është mesazhi i paqes dhe i sigurisë. Ai ka qenë i vërteti, besniku. Njerëzit e njihnin, e njohin dhe do ta njohin deri në fund të kësaj jete si të tillë. Për atë, Allahu i Madhëruar thotë: **“Vërtet, ti je në skajet e larta të moralit”**. Ai e mbarti mesazhin e Allahut në zemrën e tij, në gjuhën e tij e në çdo hap të jetës së tij dhe ua përcolli të gjithë njerëzve. Ai është përkthyer dhe është botuar në shumë gjuhë të ndryshme të botës. Për përhapjen e këtij mesazhi, ai duroi tortura, mundime, persekutime e dhembje nga më të ndryshmet. Vetë Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*) ka thënë: *“Asnjë profeti nuk i është bërë keq, siç më është bërë mua”*.

Fjalët e smirakëve nuk e penguan atë në veprën e tij. Talljet dhe mendjemadhësitë e njerëzve të asaj kohe nuk e



ndaluan ta shpallte e ta përhapte mesazhin e Allahut. Prandaj sot, më shumë se një miliardë e gjysmë myslimanë vazhdojnë ta pasojnë atë me dëshirë e dashuri.

Gabon rëndë ai që thotë se ky mesazh është përhapur me shpatë. Vetë Allahu e cilëson Profetin Muhamed (Paqja e bekimi i Allahu qoftë mbi të e mbi familjen e tij!) mëshirë për mbarë botët, kur thotë: **“Dhe Ne nuk të kemi dërguar ty (o Muhamed), veçse si mëshirë për botët”**.¹

Dhe: **“Në saje të mëshirës së Allahut, u solle butësisht me ta (o Muhamed). Sikur të ishe i ashpër dhe i vrazhdë, ata do të largoheshin prej teje. Prandaj falua atyre gabimin, kërkoji falje Allahut për ata dhe këshillohu me ata për çështje të ndryshme. Kur të vendosësh për diçka, mbështetu tek Allahu. Vërtet, Allahu i do ata që mbështeten tek Ai”**.²

Dhe: **“Tashmë ju ka ardhur një i Dërguar nga gjiri juaj. Atij i vjen rëndë për gjynahet që bëni ju, jua dëshiron të mirën me gjithë zemër, që ju të shkoni rrugës së drejtë dhe është i butë e i mëshirshëm me besimtarët”**.³

Në Kur'an lexojmë se Allahu ia ka qartësuar Profetit të Tij se si ta përhapte fenë islame, kur thotë: **“Thirr në rrugën e Zotit tënd me mençuri dhe me këshillë të bukur**

1 Sure “El- Enbija”, ajeti 107

2 Sure “Al Imran”, ajeti 159.

3 Sure “Et-Teube”, ajeti 128.



dhe diskuto me ata në mënyrën më të mirë! Me të vërtetë, Zoti yt i di më së miri ata që janë shmangur nga rruga e Tij, i di më së miri ata, që janë në rrugë të drejtë”.⁴

Dhe: Thuaj: “O ithtarët e Librit, ejani të biem në një fjalë të përbashkët mes nesh dhe jush se do të adhurojmë vetëm Allahun, se nuk do t’i shoqërojmë Atij askënd e asgjë (në adhurim) dhe se nuk do ta mbajmë për zot njëritjetrin në vend të Allahut!” Nëse ata nuk pranojnë, atëherë thuaju: “Dëshmoni se ne i jemi nënshtruar Allahut!”⁵

Këto ajete të Allahut të Madhëruar e të tjera si këto në Kur’an, qartësojnë se Islami nuk është përhapur me gjuhën e shpatës, siç mëtojnë (pretendojnë) disa mendje dashakeqëse e djallëzore. Vallë, a shkon dhuna me mëshirën?! A shkon ashpërsia me butësinë?! A shkon zënka me dialogun?! Asnjëherë. Ata që thonë se Islami është përhapur me dhunë e me shpatë, duan ta shuajnë dritën e Allahut me gjuhët e tyre. Por më kot mundohen, sepse Allahu na thotë në Kur’an: **“Ata dëshirojnë ta fikin dritën (fenë) e Allahut me gojën e tyre, por Allahu ka vendosur vetëm që ta përsosë dritën e Vet, edhe sikur mohuesit ta urrejnë këtë gjë”.⁶**

4 Sure “En-Nahl”, ajeti 125.

5 Sure “Al Imran”, ajeti 64.

6 Sure “Et-Teube”, ajeti 32.



Kur flitet për Profetin Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*), flitet për Islamin, flitet për mrekullinë e përjetshme të Fjalës së Allahut, Kur'anin e Shenjtë, të cilin Allahu e zbriti për t'i nxjerrë njerëzit nga errësira në dritë, siç thuhet në fillim të sures "Ibrahim": **"Elif. Lâm. Râ. Këtë Libër ta kemi shpallur ty (o Muhamed), për t'i nxjerrë njerëzit, me lejen e Zotit të tyre, nga errësira në dritë, në rrugën e të Plotfuqishmit, të Denjit për çdo lavd".**⁷

Allahu i Madhëruar, Zotëruesi i fuqisë, i dijes dhe i urtësisë absolute, i ka krijuar njerëzit dhe u ka dhuruar atyre mirësitë dhe dhuntitë e Tij. Njeriu, krijesa e përkryer dhe më e larta e gjithësisë, që nga lindja e deri në çastin e ndarjes nga kjo jetë, jeton nën kujdesin e Allahut. Kjo vërtetohet, nëse përqendrohemi në jetën tonë të përditshme, nga foshnjëria, në rini e deri në pleqëri.

Allahu nuk dëshiron që njerëzit të shkojnë drejt humbjes dhe shkatërrimit. Sigurisht, njeriu, me anë të mendjes së tij, bën dallimin mes të mirës dhe të keqes, mes asaj që i sjell dobi dhe asaj që i sjell dëm, mes rrugës së drejtë dhe rrugës së shtrembër. Por pa udhëzues, mendja nuk mund ta drejtojë njeriun në rrugën e drejtë e të vërtetë. Prandaj, Allahu i ka dhënë mirësi njeriut me dërgimin e

⁷ Sure "Ibrahim", ajetet 1-2.



profetëve, të cilët janë: **“përgëzues dhe qortues”**, siç thuhet në suren “El-Enbija”, në ajetin 25.

Historia e jetës së Profetit tonë të dashur, Muhamedit, është më e qartë se historitë e profetëve paraardhës. Nga profetët e mëparshëm kanë mbetur ato gjurmë të vërteta që ka ruajtur Islami nëpërmjet Librit të tij, Kur’anit të Shenjtë.

Mesazhi i Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*) është shumë i lehtë dhe përmban kuptime të ndritura, që e pasurojnë dhe e ndriçojnë mendjen dhe zemrën e shëndoshë të çdo njeriu.

Mesazhi që solli Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*) është i pastër nga legjendat dhe paganizmi.

Mesazhi që shpalli Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*) sjell qetësi, ngrohtësi dhe paqe në shpirt, sepse përmendet Allahu. Në Kur’an thuhet: **“Sigurisht, me përmendjen e Allahut qetësohen zemrat”**.⁸

Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*) ka qenë vetë Kur’ani, sepse i gjithë

8 Sure “Er-Rra’ad”, ajeti 28.



Kur'ani ishte kristalizuar në vetë qenien e tij. Kur ecte, kur fliste e ndriçonte çdo gjë me dritën e Kur'anit.

Ai është drita e pashuar, edukuesi i përkryer dhe udhëheqësi më i drejtë. Prandaj, ai ka qenë, është dhe do të mbetet shembull për të gjithë njerëzit e çdo kohe dhe të çdo vendi, pa dallim kombi, race, gjuhe e ngjyre. Në Kur'an thuhet: **“Në të Dërguarin e Allahut ka një shembull të mrekullueshëm për atë, që shpreson tek Allahu dhe tek Dita e Fundit dhe e përmend shumë Allahun”.⁹**

Prania e Profetit tonë të dashur ka qenë, është dhe do të mbetet themeli më i fortë i unitetit të myslimanëve. Ashtu si s'ka kuptim jeta pa dritë, pa qetësi e pa paqe, po ashtu, ajo nuk ka kuptim pa praninë e Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*), sepse besimi i myslimanëve te Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*) shoqërohet e bashkohet me dashurinë dhe përmallimin për të. Ai është strumbullari i dashurisë dhe i bashkimit të mbarë myslimanëve. Prania e tij i zbut zemrat e myslimanëve e i bashkon ata me njëri-tjetrin.

Dashuria për Profetin Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*) është rruga drejt Xhenetit dhe porta e dashurisë së Allahut të Madhëruar. Dashuria për Profetin (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e*

⁹ Sure “El-Ahzab”, ajeti 21.



mbi familjen e tij!) është dashuri dhe singëritet për Allahun Fuqiplotë.

Ta duash Profetin Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*), do të thotë të zbatosh porositë, këshillat, urdhëresat dhe ndalesat që ai ka urdhëruar. Zbatimi i Sunetit të Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*) është argumenti më i madh dhe më i fuqishëm i dashurisë për të. Prandaj, është detyrë e të gjithë myslimanëve, që të njihen dhe ta zbatojnë Sunetin (fjala, vepra, çfarë ka bërë e çfarë nuk ka bërë Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*)). Suneti i Profetit është shpallje e shpallur, siç thotë Kur'ani: **“Ai nuk flet sipas dëshirës së vet, por ajo (që thotë) është vetëm shpallje e shpallur, që i vjen atij. Atë ia ka mësuar atij një (melek) shumë i fuqishëm (Xhebraili)”**.¹⁰

Në një ajet tjetër, Kur'ani thotë: **“...Çfarëdo që t'ju japë i Dërguari, merreni atë, e çfarëdo që t'ju ndalojë, hiqni dorë prej saj...!”**¹¹

Dhe: **“Nuk i takon asnjë besimtari a besimtareje të vërtetë që, kur Allahu dhe i Dërguari i Tij vendosin për**

10 Sure “En-Nexhm”, ajetet 3-5.

11 Sure “El-Hashr, ajeti 7.



një çështje, ata të kenë të drejtë të zgjedhin në atë çështjen e tyre..."¹²

Dhe: "Thuaju (o Muhamed): 'Nëse ju e doni Allahun, atëherë më ndiqni mua, që Allahu t'ju dojë dhe t'jua falë gjynahet! Allahu është Falës i Madh dhe Mëshirëplotë'".¹³

Ajetet e mësipërme na thonë se dashuria për Profetin Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*) dhe zbatimi i Sunetit të tij është detyrë për çdo mysliman dhe myslimane. Dashuria dhe ndjekja e tij nxjerr në pah besimin dhe dashurinë tonë për Allahun e Madhëruar.

Kundërshtimi i Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*) është humbje. Këtë e përforcon ajeti i Kur'anit, që thotë: **"...Kush e kundërshton Allahun dhe të Dërguarin e Tij, ai me siguri ka humbur"**.¹⁴

Kurse vetë Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*) ka thënë: *"Askush nuk ka besuar, derisa unë të jem më i dashur tek ai sesa fëmijët e tij, prindërit e tij dhe të gjithë njerëzit"*.

12 Sure "El-Ahzab", ajeti 36.

13 Sure "Al Imran", ajeti 31.

14 Sure "El-Ahzab", ajeti 36.



Kur'ani thotë: **“Thuaj: “Nëse etërit tuaj, bijtë tuaj, vëllezërit tuaj, gratë tuaja, farefisi juaj, pasuria juaj që e keni fituar, tregtia për të cilën keni frikë se nuk do të shkojë mirë dhe shtëpitë ku e ndieni veten rehat, janë më të dashura për ju sesa Allahu, i Dërguari i Tij dhe lufta në rrugën e Tij, atëherë prisni, derisa Allahu të sjellë vendimin (dënimin) e Tij. Allahu nuk e udhëzon në rrugën e drejtë popullin e pabindur”**. Dhe: **“I Dërguari është më i afërt për besimtarët, sesa ata për njëritjetrin...”**¹⁵

E kanë pyetur Imam Aliun (Paqja qoftë mbi të!): *“Si ka qenë dashuria juaj për Profetin Muhamed (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!)?”* Ai ka thënë: *“Ai ka qenë më i dashur te ne, sesa pasuritë tona, fëmijët tanë, baballarët tanë, nënat tona dhe uji i ftohtë për të eturin”*.

Pas Allahut të Plotfuqishëm, Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*) e meriton, vërtet dashurinë më të madhe, sepse ai është njeriu i përkryer që ka parë e do të shohë gjithësia. Allahu na e përshkruan në mënyrë madhështore në Kur'anin e shenjtë qëllimin e dërgimit të Profetit Muhamed: **“O Profet! Ne të kemi dërguar ty si dëshmitar, sjellës të lajmit të mirë dhe paralajmërues; njëherësh, (të kemi dërguar) si thirrës, që i fton njerëzit në rrugën e Allahut, me urdhrin e Tij dhe si**

15 Sure “El-Ahzab”, ajeti 6.



pishtar ndriçues. Jepu lajmin e mirë besimtarëve se Allahu ka (përgatitur) për ata dhunti të madhe! Mos i dëgjo mohuesit dhe hipokritët! Mos i përfill fyerjet e tyre dhe mbështetu tek Allahu! Allahu mjafton për mbrojtës”.¹⁶

Allahu i Madhëruar na e ka bërë detyrë dërgimin e salavateve për Profetin Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*) dhe për familjen e tij të pastër. Dërgimi i salavateve është shenjë e dashurisë për Profetin Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*).

Në Kur'an thuhet: “Vërtet, Allahu e bekon të Dërguarin dhe engjëjt e Tij luten për atë. O ju që keni besuar, lutuni për atë dhe përshëndeteni me ‘selam’”.¹⁷

Dërgimi i salavateve ka mirësi të mëdha. Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*) ka thënë: “Kush më dërgon mua një salavat, Allahu do t'i dërgojë atij dhjetë salavate.”

Është mirë që salavatet të thuhën në çdo kohë. Po ashtu, është mirë që salavatet të thuhën para dhe pas ezanit, para dhe pas ikametit, në ruku e në sexhde, në teshehud, para dhe pas një duaje, para dhe pas leximit a këndimit të

16 Sure “El-Ahzab”, ajetet 45-48.

17 Sure “El-Ahzab”, ajeti 56.



Kur'anit, para hyrjes në xhami dhe pas daljes prej saj, sa herë të përmendet emri i tij, në ditën e xhuma dhe natën e xhuma, në festat e bajrameve etj.

Allahu na mbarësoftë, që ta ndjekim rrugën e tij në këtë jetë dhe na bashkoftë me të dhe me familjen e tij të pastër në Ditën e Gjykimit!



PROFETI MUHAMED

(Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!)

NË KUR'AN

Sipas pikëpamjes dhe mendimit të personaliteteve islame, Kur'ani zë vendin e parë, sepse ai është Libër i Allahut, i cili jo vetëm e mbron personalitetin e njeriut, por e përsos atë. Ai përmban bazat dhe themelet e besimit dhe shpjegon gjithçka rreth fesë sonë të drejtë, Islamit, qoftë për çështjet individuale apo për ato të përgjithshme. Ai e drejton dhe e udhëheq shpirtin tonë drejt rrugës së drejtë. Ai është dritë dhe është i qartë. Me anë të Kur'anit, Allahu udhëzon atë që ndjek kënaqësitë e Tij dhe rrugët paqësore të mendimit, shpirtit dhe zbatimit. Ai i nxjerr njerëzit prej errësirave në dritë, me lejen e Tij dhe i udhëzon ata në rrugën e drejtë e të vërtetë. Kur'ani u sqaron njerëzve se ajo për të cilën kanë mendime të ndryshme, është udhëzim dhe mëshirë për besimtarët. Ai udhëzon në atë që është më e mira dhe më e përsosura. Ai është shërues për zemrat dhe është shenjë e Zotit të Madhëruar. Allahu thotë për Kur'anin se atij nuk i vjen e kota as nga para e as nga prapa. Ai është dokument i mbrojtur nga Allahu dhe në të nuk ka as shtesë e as mangësi. Po ashtu, Allahu thotë: **“Sigurisht, Ne e kemi shpallur Kur'anin dhe, sigurisht, Ne do ta ruajmë atë.”**



Bazuar në ato që u thanë për Kur'anin, është e domosdoshme që ai të jetë burimi i parë për jetëshkrimin e Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*). Ai flet për personalitetin e Profetit, për moralin e tij, për metodën e thirrjes e të predikimit të tij dhe për jetën e përgjithshme e personale të tij. Ai flet për marrëdhëniet e Profetit me të tjerët, qofshin besimtarë apo jobesimtarë.

Sigurisht që profetësia e Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*) është çështje e Allahut, prandaj edhe njohja më e mirë e tij arrihet nëpërmjet Librit të Allahut të Madhëruar, Kur'anit të Shenjtë. Për këtë, duhet që myslimanët të thellohen në studimin e jetës së Profetit, për t'u njohur me Profetin e tyre. Allahu i Madhëruar i urdhëron myslimanët, që ta kuptojnë Kur'anin dhe të jetojnë nën dritën e tij.

Allahu i Madhëruar e ka zbritur Kur'anin udhëzues, udhërrëfyes dhe sqarues për çdo gjë. Prandaj, siç e thamë edhe më lart, për të njohur personalitetin e Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*), duhet të bazohemi te Kur'ani. Të shumta janë ajetet që flasin për këtë njeri të madh e për këtë dritë të pashuar.

Së pari, duhet të mësojmë periudhën para profecisë. Vallë, a e ka studiuar Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i*



Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!) Teuratin (Torren) dhe Biblën (Inxhilin) para se t'i vinte profecia? A ishte i ditur për historinë e të dërguarve të mëparshëm? A dinte shkrim e këndim?

Sipas Kur'anit, Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*) nuk ka pasur njohuri për ato që thamë. Në Kur'an thuhet: **"...Allahu ta shpalli ty Librin (Kur'anin) dhe Urtësinë e plotë, si dhe të mësoi atë që nuk e ke ditur. Dhuntia e Allahut për ty është shumë e madhe".**¹⁸

"Dhe kështu, Ne të kemi dërguar ty Shpallje me urdhrin dhe vullnetin Tonë. Ti, më parë, nuk e ke ditur se çfarë është Libri e as ç'është besimi. Por atë (Kur'anin), Ne e bëmë dritë, me anë të së cilës udhëzojmë kë të duam nga robtë Tanë. Ti, me të vërtetë, udhëzon në rrugën e drejtë".¹⁹

"Ti nuk ishe i pranishëm, kur ata hodhën short se kush prej tyre do të merrte nën kujdes Merjemen dhe nuk ishe i pranishëm kur ata diskutonin".²⁰

18 Sure "En-Nisa", ajeti 113.

19 Sure "Esh-Shura", ajeti 52.

20 Sure "Al Imran", ajeti 44.



“Këto janë disa nga historitë e fshehta, të cilat Ne po t’i shpallim ty (o Muhamed). Ti nuk ke qenë me ata, kur vendosnin për punën e tyre dhe kurdisnin dredhi”.²¹

“Ti nuk ke shpresuar se do të të shpallej Libri, por e more nga mëshira e Zotit tënd; prandaj, kurrresi, mos u bëj ndihmës i mohuesve!”²²

“Unë nuk kam pasur asnjë dijeni për Grupin më të Lartë, kur diskutonin mes tyre (për krijimin e Ademit)”.²³

“Thuaj: ‘Sikur të kishte dashur Allahu, unë nuk do t’jua kisha lexuar dhe Ai as që do të bënte që ju ta mësoni atë. Unë kam jetuar një kohë (të gjatë) në mesin tuaj para profetësisë, a nuk po mendoni?’”²⁴

“Para këtij, ti (Muhamed) nuk kishe lexuar kurrfarë libri e as që kishe shkruar gjë me dorën tënde; përndryshe, ndjekësit e të pavërtetës do të dyshonin”.²⁵

E gjitha kjo është argument i profecisë së tij, sepse gjithë kjo kulturë nuk mund të fitohet me përpjekje njerëzore, veçanërisht, kur ai që ka këtë kulturë të gjerë, nuk ka ditur të shkruajë e as të lexojë. Por kjo nuk do të thotë se

21 Sure “Jusuf”, ajeti 102.

22 Sure “El-Kasas”, ajeti 86.

23 Sure “Sad”, ajeti 69.

24 Sure “Junus”, ajeti 16.

25 Sure “El-Ankebut”, ajeti 48.



Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*) nuk ka pasur kulturë të lartë nëpërmjet meditimeve që bënte dhe nëpërmjet dhuntive të Allahut për të, gjatë kohës së përgatitjes së tij për të mbartur këtë mision të lavdishëm e universal, që është mesazhi islam.

Kur'ani i shenjtë na thotë qartë se Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*) është mbartësi i mesazhit. Allahu i Madhëruar për këtë, thotë: **“O Profet! Ne të kemi dërguar ty si dëshmitar, sjellës të lajmit të mirë dhe paralajmërues; njëkohësisht (të kemi çuar) si thirrës, që i fton njerëzit në rrugën e Allahut me urdhrin e Tij dhe si pishtar ndriçues”**.²⁶

“Është Ai që u solli analfabetëve një të Dërguar nga gjiri i tyre, për t’u lexuar atyre shpalljet e Tij, për t’i pastruar e për t’u mësuar Librin dhe Urtësinë, ndonëse ata, më parë, ishin vërtet në humbje të plotë”.²⁷

“...një të Dërguar, i cili ju lexon shpalljet e Allahut me shpjegime të qarta, për t’i nxjerrë ata që besojnë dhe bëjnë vepra të mira, nga errësira në dritë...”²⁸

Në ajetet e lartpërmendura, duket qartë roli udhëheqës dhe edukues i Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*) për njerëzit. Po ashtu,

26 Sure “El-Ahzab”, ajetet 45-46.

27 Sure “Xhumua”, ajeti 2.

28 Sure “Et-Talak”, ajeti 11.



ai është dëshmitar, që dëshmon për bashkësinë, duke i treguar asaj rrugën e vërtetë e të drejtë. Ai u lexon atyre ajetet e Allahut dhe u mëson atyre Librin që u nevojitet nga ana teorike dhe u mëson urtësinë që u nevojitet për anën praktike të jetës së tyre. Ai është përgëzues për besimtarët punëmirë, se ata do të kenë shpërblim të mirë. Gjithashtu, është edhe tërheqës i vëmendjes ndaj dënimit të dhimbshëm. Ai është edukuesi dhe pastruesi i zemrave prej të këqijave dhe ndyrësive mendore. Ai i nxjerr njerëzit prej errësirave të paditurisë e të mosbesimit, të idhujtarisë e të humbjes, të prapambetjes e devijimit, në dritën e besimit e të dijes, të monoteizmit e të udhëzimit, të përparimit e të qytetërimit në horizontet e dashurisë për Allahun, për jetën dhe për njerëzit. Ai nuk ka ardhur që të hedhë poshtë mesazhet që sollën profetët paraardhës dhe as t'i mohojë ata. Ai erdhi dëshmues dhe vërtetues për ato që sollën profetët e tjerë, siç thotë Allahu i Madhëruar në Kur'an: "...pastaj juve ju erdhi një i Dërguar, vërtetues i asaj që ju është dhënë..."²⁹

Ai i dëshmonte librat paraardhës dhe ua sqaronte ato njerëzve. Allahu i Madhëruar thotë: **"O ithtarët e Librit! Juve ju erdhi i Dërguari Ynë, i cili ju shpjegon gjëra nga**

29 Sure "Al Imran", ajeti 81.



ato që i keni fshehur ju prej Librave (Teuratit dhe Ungjillit) dhe ju fal shumë...”³⁰

Ai e shfaqte besimin për të gjithë të dërguarit: “...Ne nuk bëjmë dallim mes asnjërit prej të dërguarve të Tij...”³¹

Po të studiohen me kujdes ajetet e Kur'anit, që flasin për metodën thirrëse të Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*), do të vërejmë se ai nuk detyronte askënd, që të besonte dhe të bënte punë të mira.

Allahu i Madhëruar thotë në Kur'an: “Prandaj këshilloji (njerëzit o Muhamed), se ti je vetëm këshillues; dhe nuk je ngarkuar t'i detyrosh ata me forcë!”³²

“Kush i bindet të Dërguarit, i është bindur Allahut. Sa për ata që kthejnë kokën mënjane, Ne nuk të kemi dërguar që të jesh rojtari i tyre”.³³

“...i Dërguari ka për detyrë vetëm që të shpallë qartazi”.³⁴

30 Sure “El-Maide”, ajeti 15.

31 Sure “El-Bekare”, ajeti 285.

32 Sure “El-Gashije”, ajetet 21-22.

33 Sure “En-Nisa”, ajeti 80.

34 Sure “El-Ankebut”, ajeti 18.



“Ne e dimë mirë çfarë thonë ata, por ti nuk do t’i detyrosh ata me dhunë (që të besojnë). Prandaj, këshillo me Kur’anin këdo që ka frikë paralajmërimit Tim!”³⁵

Ka edhe shumë ajete të tjera që flasin rreth kësaj teme.

Bazuar në këto ajete, duket qartë misioni profetik, i cili fton në besim, por jo me gjuhën e dhunës e të forcës, por me gjuhën e këshillës dhe të fjalës së mirë. Në çdo hap e lëvizje, Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*) sillej ashtu siç e kishte mësuar Allahu. Ai ishte urdhëruar, që t’ua paraqiste veten e tij njerëzve, duke u thënë: **“(Thuaju, o Muhamed): ‘Unë jam urdhëruar që të adhuroj vetëm Zotin e këtij Qyteti (Mekës), i Cili e ka bërë atë të shenjtë dhe të Cilit i përket gjithçka. Jam urdhëruar që t’i nënshtrohem Atij; dhe të këndoj Kur’anin’. Kushdo që merr rrugën e drejtë, e bën për dobi të vet. Ndërsa atyre që devijojnë, ti thuaju: ‘Unë jam vetëm paralajmërues’. Dhe thuaj: ‘Falënderimi qoftë për Allahun, Ai do t’jua tregojë shenjat e Tij e ju do t’i njihni ato!’ E Zoti yt, nuk është i pakujdesshëm ndaj veprave që bëni ju”.**³⁶

Me ndihmën e Allahut dhe bazuar në mësimet e Tij, Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*) nisi rrugën e predikimit me urtësi, me fjalë të

35 Sure “Kaf”, ajeti 45.

36 Sure “En-Neml”, ajetet 91- 93.



ëmbla e të buta dhe me një qetësi e zemërgjerësi të paparë. Kjo ishte mënyra më e mirë për të depërtuar në mendjet dhe zemrat e të tjerëve. Ai ishte urdhëruar, që të udhëzonte njerëzit në rrugën e besimit të drejtë e të vërtetë e ky besim të ishte i bazuar në bindje dhe i palëkundur.

Në një ajet të Kur'anit, për ata që kanë besim të lëkundur, thuhet: **“Disa njerëz të tjerë e adhurojnë Allahun me kusht: Nëse u ecën mbarë, janë të kënaqur, por, nëse i godet fatkeqësia, ata kthehen në mohim e kështu humbasin këtë botë dhe tjetrën. Pikërisht kjo, është humbja e qartë”**.³⁷

Pra, përqafimi dhe ndjekja e Islamit nuk është me forcë e me dhunë, por me dëshirë dhe e bazuar te studimi dhe njohja e tij. Ka shumë njerëz, që, për arsye të mosnjohjes së fjalës së Allahut, nuk besojnë. Për këtë, është detyrë që të ndiqet metoda e Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*) në përhapjen dhe sqarimin e fjalës së Allahut, me qëllim që njerëzit të njihen sa më shumë me të dhe ta dinë se rruga e vetme e shpëtimit në këtë jetë dhe në Jetën Tjetër është zbatimi i kësaj fjale, i Kur'anit të shenjtë.

37 Sure “El-Haxhxh”, ajetit 11.



METODA E THIRRJES SË PROFETIT MUHAMED

(Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!)

SIPAS KUR'ANIT

Qëllimi kryesor i misionit të Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*) ishte që në mendjet dhe zemrat e njerëzve të mbizotëronte feja e Allahut, çdo gjë që të vepronin, ta bënë për Allahun, të mos adhurohej tjetër, përveç Allahut; veprat dhe lëvizjet e njerëzve të bazoheshin te logjika e shëndoshë dhe jo te emocioni dhe instinkti. Sa bukur na e paraqet Kur'ani metodën e thirrjes në rrugën e Allahut të Madhëruar! Sa nevojë kanë njerëzit e sotëm të njihen me këtë lloj metode dhe ta zbatojnë në jetën e tyre të përditshme! Jam i bindur se po të zbatohet kjo metodë kur'anore në jetën e përditshme, në shoqëritë njerëzore nuk do të ketë konflikte e as mosmarrëveshje, as luftëra e as gjakderdhje, as mashtrime e as padrejtësi. Vallë, sa lart do të ishte Islami, nëse myslimanët do të zbatonin fjalën e Allahut, Kur'anin e shenjtë? Më poshtë do përmendim disa ajete nga Kur'ani, që na mësojnë se si të bashkëpunojmë me të tjerët.



Allahu i Madhëruar thotë: **“Thirr në rrugën e Zotit tënd me mençuri dhe këshillë të bukur dhe diskuto me ata në mënyrën më të mirë! Me të vërtetë, Zoti yt i di më së miri ata që janë shmangur nga rruga e Tij dhe di më së miri ata që janë në rrugë të drejtë”**.³⁸

“Nëse ata të quajnë gënjeshtar, thuaju: ‘Unë kam (shpërblim për) punën time, kurse ju keni (shpërblim për) punën tuaj. Ju s’jeni përgjegjës për atë që bëj unë dhe as unë s’jam përgjegjës për atë që bëni ju’”.³⁹

“Nëse ata grinden me ty, thuaju: ‘Allahu e di më së miri atë që bëni ju’”.⁴⁰

“Diskutoni me ithtarët e Librit vetëm me mënyrën më të mirë, por jo me keqbërësit e tjerë. Dhe thoni: ‘Ne besojmë në atë që na është zbritur neve dhe në atë që ju është zbritur juve. Zoti ynë dhe Zoti juaj është një - dhe ne Atij i nënshtrohemi si myslimanë’”.⁴¹

“E kush flet më bukur se ai që i fton njerëzit drejt Allahut, bën vepra të mira dhe thotë: ‘Unë, me të vërtetë, jam mysliman’. Nuk barazohet e mira me të keqen! Të

38 Sure “En-Nahl”, ajeti 125.

39 Sure “Junus”, ajeti 41.

40 Sure “El-Haxh”, ajeti 68.

41 Sure “El-Ankebut”, ajeti 46.



keqen ktheje me të mirë e atëherë armiku yt do të të bëhet menjëherë mik i ngushtë”.⁴²

“Prandaj, ti thirru dhe bëhu këmbëngulës, ashtu siç je urdhëruar; mos i ndiq epshtet e tyre dhe thuaj: ‘Unë besoj çdo libër që e ka shpallur Allahu dhe jam urdhëruar që të gjykoj drejt midis jush; Allahu është Zoti ynë dhe Zoti juaj. Veprat tona janë për ne, e veprat tua janë për ju. Midis nesh dhe jush nuk ka kurrfarë mosmarrëveshje. Allahu do të na tubojë të gjithëve dhe tek Ai do të kthehemi të gjithë’”.⁴³

“Thuaju: ‘Kush ju furnizon juve prej qiejve dhe prej Tokës?’ - Thuaju: ‘Allahu!’ Ne nuk mund të jemi që të dyja palët në rrugën e drejtë, ose ju, ose ne jemi në humbje të qartë!’”⁴⁴

Kjo është metoda islame e thirrjes, e cila nuk bazohet te dhuna e te presioni, por te logjika dhe te ndjenjat e njeriut. Ajo bazohet te fjala e butë dhe te dialogu i qetë e argumentues, me qëllim që edhe njerëzit e tjerë të jetojnë të qetë shpirtërisht e logjikisht. Sa e mrekullueshme është thënia e Kur’anit, që tregon se si të flasim me pasuesit e feve të tjera! Allahu i Madhëruar thotë: “Thuaj: ‘O ithtarët e Librit, ejani të biem në një fjalë të përbashkët mes nesh

42 Sure “El-Fusilet”, ajetet 33-34.

43 Sure “Esh-Shura”, ajeti 15.

44 Sure “Sebe”, ajeti 24.



dhe jush: se do të adhurojmë vetëm Allahun, se nuk do t'i shoqërojmë Atij asgjë (në adhurim) dhe se nuk do ta mbajmë për zot njëri-tjetrin, në vend të Allahut!' Nëse ata nuk pranojnë, atëherë thuaju: 'Dëshmoni se Ne i jemi nënshtruar Allahut!'"⁴⁵

A ka mësim më të përkryer se ky mësim kur'anor?

45 Sure "Al Imran", ajeti 64.



MORALI I PROFETIT MUHAMED

(Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!)

NË THIRRJE

Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*) ka qenë në piedestalin më të lartë të moralit, në të gjitha anët. Ai ka qenë shumë i sjellshëm me njerëzit, mendjendritur dhe çdo gjë e priste me dashuri e zemërgjerësi. Ai ka qenë zemërbutë me njerëzit, qofshin miq apo armiq. Nuk ka qenë i ashpër, i rreptë, zemërgur e mendjelehtë. Ai ka qenë siç na thotë Allahu në Kur'an: **"Në saje të mëshirës së Allahut, u solle butësisht me ta (o Muhamed). Sikur të ishe i ashpër dhe i vrazhdë, ata do të largoheshin prej teje. Prandaj falua atyre gabimin, kërkoi falje Allahut për ata dhe këshillohu me ata për çështje të ndryshme. Kur të vendosësh për diçka, mbështetu tek Allahu. Vërtet, Allahu i do ata që mbështeten tek Ai".**⁴⁶

"...se ti je me virtyte madhore".⁴⁷

"Tashmë ju ka ardhur një i Dërguar nga gjiri juaj. Atij i vjen rëndë për gjynahet që bëni ju, jua dëshiron të

46 Sure "Al Imran", ajeti 159.

47 Sure "El-Kalem", ajeti 4.



mirën me gjithë zemër, që ju të shkoni rrugës së drejtë dhe është i butë e i mëshirshëm me besimtarët”.⁴⁸

Në disa ajete të Kur'anit mësojmë se Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*) zemërohej shumë, kur i shihte njerëzit që këmbëngulnin në mosbesim. Çështja arriti deri atje, sa që Allahu, në disa ajete të Kur'anit, thotë: **“Mos u pikëlloni (o Muhamed) për shkak të tyre dhe mos u ngushtoni për kurthet e tyre”.⁴⁹**

“...Ti mos e shqetëso veten deri në shkatërrim për humbjen e tyre! Allahu është vërtet i Gjithëditur për atë që bëjnë ata”.⁵⁰

“A mos vallë do të vrasësh veten nga pikëllimi, nëse ata nuk besojnë në këtë Fjalë (Kur'an)?”⁵¹

Kjo është ana shpirtërore e mesazhit, me të cilën, çdo thirrës islam duhet të jetë i pajisur në misionin e thirrjes e të predikimit. Ai duhet t'u dojë njerëzve humanizmin e tyre dhe t'u përbuzë mosbesimin. Zemra e tij duhet të pikojë gjak nga hidhërimi, kur të shohë njerëz jobesimtarë. Ky është sekreti i suksesit të predikuesit. Fjalët e tij duhet të dalin nga mendja e shëndoshë dhe nga zemra e pastër dhe t'i dojë njerëzit, sepse dashuria përmban fuqi për shkatërrimin e

48 Sure “Et-Teube”, ajeti 128.

49 Sure “En-Neml”, ajeti 70.

50 Sure “El-Fatir”, ajeti 8.

51 Sure “El-Kehf”, ajeti 6.



shumë pengesave shpirtërore mes thirrësit dhe njerëzve të tjerë.

Ishte dëshira e Allahut që Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*) të qëndronte me të varfrit besimtarë, sepse ata ishin të pastër e të papërlyer nga egoizmi apo mendjemadhësia.

Gjithashtu, të kuptohej se varfëria nuk është mangësi personaliteti te njeriu. Është detyrë e thirrësve, që të forcojnë marrëdhëniet me të varfrit e jo t'i largojnë ata e të afrojnë të pasurit. Në një ajet të Kur'anit, lexojmë: **“Mos i dëbo ata që i luten Zotit të vet në mëngjes e mbrëmje, duke e dëshiruar fytyrën (mirësinë) e Tij! Ti nuk je aspak përgjegjës për ata e as ata nuk janë përgjegjës për ty. Nëse ti i dëbon ata, atëherë do të jesh keqbërës”**.⁵²

“Dhe qëndro me ata që i luten Zotit të vet në mëngjes dhe mbrëmje, duke dëshiruar fytyrën (kënaqësinë) e Tij dhe mos i shmang sytë nga ata (tek të tjerët), duke dëshiruar stolitë e shkëlqimin e kësaj jete. Mos dëgjo atë, zemrën e të cilit ia kemi lënë mospërfillëse ndaj përmendjes Sonë e që shkon pas dëshirave të veta, duke shkelur çdo kufi në veprimet e veta”.⁵³

52 Sure “El-En’am”, ajeti 52.

53 Sure “El-Kehf”, ajeti 28.



Allahu e urdhëron të Dërguarin e Tij që të jetë modest, i thjeshtë dhe i buzëqeshur me besimtarët. Allahu i Madhëruar thotë në Kur'an: **“Kur të vijnë te ti ata që besojnë në shpalljet Tona, thuaj: ‘Paqja qoftë mbi ju!’ Zoti juaj ia ka bërë detyrim Vetes mëshirën. Nëse dikush nga ju bën ndonjë vepër të keqe pa e ditur, e pastaj pendohet e përmirësohet, ai do ta gjejë Allahun Falës dhe Mëshirues”**.⁵⁴

Bazuar në këto ajete, sa e ndjekim ne shembullin e Profetit Muhamed?

54 Sure “El-En’am”, ajeti 54.



PROFETI MUHAMED

(Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!)

KUR'ANI FOLËS

Për çdo çështje apo fjalë, e pyesnin Profetin Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*): “A është prej tij, apo është shpallje nga Allahu?”, me qëllim që të qartësonin qëndrimet e tyre. Por duhet të dihet se Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*) nuk ka pasur dy personalitete në çështjet e përgjithshme e të posaçme. Ai ka pasur një personalitet, i cili ishte trup i gjallë me mesazhin. Ai ishte Kur’ani folës, në çdo aspekt të jetës së tij, qoftë në vepra, në thënie, në miratime e vendime. Allahu i Madhëruar thotë në Kur’an: **“Ai nuk flet sipas qejfit të vet, por ajo (që thotë) është vetëm shpallje e Zotit, që i vjen atij”**.⁵⁵

“Jo, për Zotin tënd, ata nuk do të jenë besimtarë të vërtetë, derisa të të marrin ty për gjyqtar për kundërshtitë mes tyre; e pastaj, të mos ndiejnë kurrfarë dyshimi ndaj gjyqimit tënd dhe të të binden ty plotësisht”.⁵⁶

55 Sure “En-Nexhm”, ajetet 3-4.

56 Sure “En-Nisa”, ajeti 65.



“Në të Dërguarin e Allahut ka një shembull të mrekullueshëm për atë që shpreson tek Allahu dhe Dita e Fundit dhe e përmend shumë Allahun”.⁵⁷

Ai është shembull në gjithçka. Ai ka qenë i pastër e i pamëkatë gjatë gjithë jetës së tij, që në vegjëli e deri në fund të jetës së tij. Fjala e tij me veprën ka qenë një dhe kurrë nuk binin ndesh me njëra-tjetrën. Ai është shembulli më i përkryer për mbarë njerëzit, sepse përfaqëson të gjitha vlerat e larta morale dhe njerëzore. Toka nuk ka parë dhe nuk do të shohë njeri më të dëlirë e më të pastër se Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*).

57 Sure “El-Ahzab”, ajeti 21.



TË QENIT NJERI

Kur'ani i shenjtë dëshmon se Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*) ka qenë njeri si të gjithë njerëzit e tjerë, njësoj si të dërguarit e tjerë paraardhës. Ndryshimi ishte se ai ka qenë i zgjedhuri i Allahut dhe i Dërguari i Tij për të udhëzuar njerëzit në rrugën e drejtë, bazuar në mësimet e Zotit.

Kur'ani e urdhëron Profetin Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*), që t'u thotë njerëzve: **"Thuaj: 'Unë jam vetëm një njeri si ju, që më është shpallur se Zoti juaj është një Zot i Vetëm'. Kështu, kush shpreson takimin me Zotin e vet, le të bëjë vepra të mira dhe të mos i shoqërojë askënd në adhurim Zotit të vet!"**⁵⁸

Në një ajet tjetër sqarohet edhe më shumë të qenit e tij njeri si të gjithë njerëzit e tjerë. Ajeti thotë: **"Unë nuk ju them se kam thesarin e Allahut apo që e di të padukshmen. As nuk them se unë jam engjëll e as do t'u them atyre, të cilët sytë tuaj i nënçmojnë, se Allahu nuk do t'u japë kurrfarë të mire. Allahu e di më mirë se ç'ka në**

58 Sure "El-Kehf", ajeti 110.



shpirtrat e tyre. Atëherë, sigurisht që do të isha prej të padrejtëve”.⁵⁹

“Thuaj: ‘Unë nuk ju them se zotëroj thesaret e Allahut apo se e di të padukshmen dhe as nuk them se jam engjëll. Unë ndjek vetëm atë që më shpallet’. Thuaj: ‘A barazohet i verbri me atë që sheh? A s’po mendoni?’”⁶⁰

Nga këto ajete mësojmë se Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*) nuk ka asgjë nga ato që përmendin ajetet, por ai zbaton ato që i është shpallur nga Allahu i Madhëruar.

Të qenit profet, rob i Allahut, sqarohet në këtë ajet: **“Thuaj: ‘Unë nuk mund t’i sjell vetes as dobi, as dëm, përveçse aq sa dëshiron Allahu. Sikur ta dija të padukshmen, do t’i shumoja të mirat dhe nuk do të më prekte asnjë e keqe. Unë jam vetëm paralajmërues dhe sjellës i lajmeve të mira për njerëzit që besojnë’”**.⁶¹

Në një ajet tjetër, përsëri rreth kësaj çështjeje, thuhet: **“Thuaju: ‘Unë nuk jam i pari i dërguar dhe nuk e di çfarë do të ndodhë me mua, ose me ju. Unë ndjek vetëm atë që**

59 Sure “Hud”, ajeti 31.

60 Sure “El-En’am”, ajeti 50.

61 Sure “El-A’raf”, ajeti 188.



më është shpallur dhe kam për detyrë të jap vetëm paralajmërime të qarta'''⁶²

Në Kur'an flitet se Allahu i Madhëruar ia shfaq gajbin atij që do prej të dërguarve të Tij, por jo se ata dinë të fshehtë. Këtë e lexojmë në suren "Xhin", në ajetet 26-28, ku thuhet: **"Vetëm Ai e di të padukshmen dhe nuk ia zbulon atë askujt, përveç të dërguarve që ka zgjedhur. Para dhe pas tyre Ai vë mbikëqyrës (engjëj), në mënyrë që ta dijë, nëse i përcjellin mesazhet e Zotit të tyre. Ai përfshin me dijen e Vet gjithçka që ata kanë dhe çdo gjë e ka llogaritur imtësisht"**.

Allahu është i Plotfuqishëm, që t'i japë kujtdo prej robëve të Tij, sidomos të dërguarve, çfarëdo fuqie, siç u ka dhënë disa të dërguarve mrekulli të ndryshme. Po ashtu, është i Plotfuqishëm që t'ua zbulojë të fshehtë. Por Kur'ani na thotë se nuk ua ka dhënë atyre këtë gjë. Ata lëviznin njësoj si lëvizin njerëzit. Përjetonin ndjenjën e dobësisë, etjes, urisë, dhimbjes, hidhërimit, gëzimit etj.

62 Sure "El-Ahkaf", ajeti 9.



SI PËRBALLEJ PROFETI

(Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!)

ME SFIDAT?

Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*) është përballur me sfidat më të ashpra ndaj të pafeve dhe politeistëve mekas. Ata e akuzonin me lloj-lloj akuzash, me qëllim që ta injoronin dhe ua paraqitnin njerëzve si një poet me metodë të re në poezi. Këtë e bënë për ta ulur nga posti i dërguesit të mesazhit. Më pas, e akuzonin se ishte gënjeshtar dhe gënjente, duke pretenduar se ishte i Dërguar. E akuzuan se ishte magjisttar dhe mendjelehtë. Së fundi, arritën të thoshin se mesazhi i tij ishte: **“Dhe ata thonë: ‘Këto janë përralla të popujve të lashtë; të cilat i ka vënë t’i shkruhen e t’i lexohen atij në mëngjes e në mbrëmje’”**.⁶³

63 Sure “El-Furkan”, ajeti 5.



“Ne e dimë mirë që ata thonë: ‘Atë e mëson një njeri! Por ai për të cilin flasim, flet në gjuhën e të huajve, kurse ky (Kur’ani) është në gjuhën e qartë arabe’”.⁶⁴

E Allahu u përgjigjet thënieve të tyre në shumë ajete, si: **“...se ky (Kur’an) është vërtet fjalë e (kumtuar prej) një të Dërguari të nderuar (Muhamedit) e nuk është fjalë poeti; sa pak që besoni! Nuk është as fjalë e ndonjë falltari; sa pak që po reflektoni! Ai është shpallje e zbritur nga Zoti i botëve!”**⁶⁵

“Nëse ata thonë: ‘Ai (Muhamedi) e ka trilluar atë (Kur’anin)’, thuaju: ‘Atëherë, sillni një sure të ngjashme me të dhe thirrni kë të mundni, përveç Allahut, nëse thoni të vërtetën’.”⁶⁶

“Vërtet thonë ata: ‘Ai e ka trilluar atë?!’ Nuk është kështu, por ata nuk besojnë. Atëherë le të sjellin një libër të ngjashëm me të, nëse ajo që thonë është e vërtetë!”⁶⁷

“Thuaj (o Muhamed): ‘Unë ju këshilloj vetëm një gjë: ngrihuni sinqerisht për Allahun, dy nga dy ose një nga një, e pastaj gjykoni për shokun tuaj (Muhamedin), që

64 Sure “En-Nahl”, ajeti 103.

65 Sure “El-Hakka”, ajetet 40-43.

66 Sure “Junus”, ajeti 38.

67 Sure “Et-Tur”, ajetet 33-34.



nuk është i çmendur. Ai është dërguar vetëm që t'ju paralajmërojë para një dënimi të rëndë'."⁶⁸

Në këto ajete shihet qartë metoda e përkryer kur'anore, në përgjigje të akuzave dhe trillimeve të jobesimtarëve, të cilat ia drejtonin Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*). Pa dyshim që kjo metodë nuk është e posaçme vetëm për jobesimtarët në kohën e Profetit Muhamed, por është për të gjitha kohët dhe për të gjithë jobesimtarët e çdo kohe dhe të çdo vendi.

Allahu na mundësoftë të jemi në rrugën e Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*) në këtë jetë dhe na bashkoftë me atë në Jetën Tjetër!

68 Sure "Sebe", ajeti 46.



PROFETI I PASHKOLLUAR MËSOI DHE EDUKOI POPUJ

Allahu i Madhëruar thotë në Kur'anin e shenjtë: **“Tashmë ju ka ardhur një i Dërguar nga gjiri juaj. Atij i vjen rëndë për gjynahet që bëni ju, jua dëshiron të mirën me gjithë zemër, që ju të shkoni rrugës së drejtë dhe është i butë e i mëshirshëm me besimtarët”**.⁶⁹

Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*) përfaqëson modelin e përsosur të humanizmit. Në personalitetin e tij ndodheshin të gjitha virtytet dhe vlerat e larta njerëzore. Ai ishte i ditur, bujar, inteligjent, i përkryer, model i urtësisë, i respektit e i madhështisë. I guximshëm, i devotshëm dhe mëshirë për mbarë krijesat. Ai ishte i pamëkatë dhe ishte në pedestalin më të lartë të moralit. Kur'ani i shenjtë thotë: **“se ti je me virtyte madhore”**.⁷⁰

69 Sure “Et-Teube”, ajeti 128.

70 Sure “Kalem”, ajeti 4.



Në veprat e tij nuk dukej asnjë mangësi e as në sjelljet e tij kundërshti.

Ai ishte zemërgjerë ndaj vështirësive dhe problemeve. Sakrifikoi ashtu si duhet në rrugën e Allahut të Madhëruar. Ishte i palëkundshëm në luftën përballë fuqive injorante, idhujtare e pagane, për të përhapur drejtësinë, lirinë, mëshirën dhe dashurinë.

Për këtë, Allahu e bëri shembullin më të mirë për mbarë njerëzit, siç thotë në Kur'anin e shenjtë: **“Në të Dërguarin e Allahut ka një shembull të mrekullueshëm për atë, që shpreson tek Allahu dhe Dita e Fundit dhe e përmend shumë Allahun”**.⁷¹

Sipas këtij ajeti të bekuar, është detyrë e të gjithë njerëzve, që ta ndjekin dhe të zbatojnë porositë e Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*).

Vërtet, ne, umeti islam, jemi bashkësi e lartë, sepse të gjitha çështjet e jetës sonë i marrim nga libri madhështor, fjala e fundit e Allahut në Tokë, Kur'ani i shenjtë dhe nga njeriu i përkryer, i cili është në piedestalin më të lartë të moralit, vula e profetëve, Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*), të cilin Allahu e dërgoi mëshirë për mbarë botët dhe ai është vula e profecisë.

71 Sure “El-Ahzab”, ajeti 21.



Allahu në Kur'an thotë: **“Dhe Ne nuk të kemi dërguar ty (o Muhamed), veçse si mëshirë për botët”.**⁷²

Kjo mëshirë për mbarë botët, u zgjodh nga Allahu i Madhëruar në mesin e shoqërisë së pashkolluar, të cilët edhe ata e njihnin si njeri të drejtë e besnik.

Edhe Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*) ishte i pashkolluar. Por i pashkolluar do të thotë të jesh i pastër me natyrën që ka krijuar Allahu dhe nuk ka mësuar në shkollë e as nga njerëzit e tjerë. As nuk është i ndikuar nga qytetërimet e kombeve të tjera, siç mund të thonë disa se ajo që ka sjellë është prej qytetërimit ku ai jetonte. Shoqëria ku lindi Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*) ishte shoqëria më e errët, më e humbur. Ajo është quajtur shoqëria e injorancës. Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*) nuk ka mësuar as nga lindorët, as nga perëndimorët. Për këtë, Allahu në Kur'anin e shenjtë, në suren “El-Ankebut”, në ajetet 48-49 thotë: **“Para këtij, ti (Muhamed) nuk kishe lexuar kurrfarë libri e as që kishe shkruar gjë me dorën tënde; përndryshe, ndjekësit e të pavërtetës do të dyshonin. Përkundrazi! Ai (Kurani) është shpallje e qartë në zemrat e atyre, të cilëve**

72 Sure “El-Enbija”, ajeti 107.



u është dhënë dija. Shpalljet Tona i mohojnë vetëm keqbërësit”.

Pra, ti, o Muhamed, nuk dije as shkrim e as këndim para zbritjes së Kur’anit, sepse ishte i pashkolluar. Por kjo nuk do të thotë se Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*) ishte i paditur.

Nëse do të dinte shkrim e këndim, jobesimtarët do të dyshonin rreth Kur’anit e do të thoshin se këtë e ka përzgjedhur nga librat e mëparshëm dhe thotë se është nga Allahu. Mirëpo, të qenit i pashkolluar, është mrekulli. Ai solli Librin sfidues, i cili përmban lajmet e të shkuarve dhe të të ardhmëve.

Vërtet, Kur’ani është mrekulli e përjetshme për Profetin Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*). Ai është argumenti më i madh dhe më i fuqishëm që vërteton profetësinë e Profetit Muhamed. Përveç Kur’anit të shenjtë, Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*) ka pasur edhe mrekulli të tjera, të cilat i kanë parë dhe i kanë dëshmuar bashkëkohësit e tij. Të gjitha këto mrekulli, tregojnë qartë pozitën e lartë të Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*).

Është detyrë e të gjithë njerëzve që ta duan, ta respektojnë dhe ta pasojnë Profetin Muhamed (*Paqja e bekimi*



i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!), të cilin Allahu e ka dërguar mëshirë për mbarë botët.

Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*) ishte, është dhe do të mbetet mësuesi më i mirë për të gjithë njerëzit. Me anë të fjalës së Allahut, Kur'anit të shenjtë, ai arriti ta ndryshojë rrënjësisht shoqërinë e asaj kohe. Ai u bë i dashur për njerëzit, sepse ftonte në drejtësi, në dashuri, në vëllazëri, në paqe, në siguri, në solidaritet dhe në dhembshuri.

Misionin e Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*) e sqaron Kur'ani i shenjtë: **“Është Ai që u solli analfabetëve një të Dërguar nga gjiri i tyre, për t’u lexuar atyre shpalljet e Tij, për t’i pastruar e për t’u mësuar Librin dhe Urtësinë, ndonëse ata më parë ishin vërtet në humbje të plotë”**.⁷³

“Allahu u ka dhënë besimtarëve dhuratë të madhe, kur u solli një të dërguar nga gjiri i tyre, i cili ua lexon shpalljet e Tij, i pastron nga gjynahet dhe u mëson Librin (Kur'anin) e urtësinë (diturinë e thellë fetare), edhe pse më parë, me të vërtetë, ata ishin në rrugë krejt të gabuar”.⁷⁴

73 Sure “Xhumua”, ajeti 2.

74 Sure “Al Imran”, ajeti 164.



Në këto dy ajete, Allahu i Madhëruar sqaron se misioni i Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*) dhe i të gjithë profetëve, ka qenë udhëzimi i njerëzve në rrugën e drejtë. Mirëpo udhëzimi nuk mund të arrihet pa pastrim, edukim dhe mësim.

Interesante në këto dy ajete është se në fillim përmendet pastrimi e më pas mësimi. Kjo do të thotë se feja e pastër islame i kushton vëmendje të madhe anës shpirtërore të njeriut. Ajo kërkon që njeriu të jetë si qelibari brenda tij. Feja islame, me anë të Kur'anit dhe Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*) është e vetmja që siguron lumturinë e vërtetë të njeriut në të dy botët. Dija dhe morali janë dy krahët më të fortë, që e bëjnë njeriun të udhëtojë drejt lumturisë.

Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*) porositi për dijen dhe kërkimin e saj. Në një hadith ai ka thënë: “Kërkimi i diturisë është detyrë e çdo myslimani dhe myslimaneje”. Gjithashtu, ka thënë: “Kërkojeni diturinë prej djepit deri në varr”. Këto porosi, Profeti ynë i dashur e jepte që shoqëria islame të edukohej dhe të ishte shembull për shoqëritë e tjera në edukim e moral. Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*) ka thënë: “Unë jam dërguar që të përsos moralet e larta”.



Për sa kohë që qëndroi në Mekën e bekuar, Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*) kurrë nuk hoqi dorë nga misioni i tij fisnik, edhe pse e lëndonin, e shanin, e ofendonin dhe e torturonin atë, së bashku me besimtarët që i besuan mesazhit të tij. Ai i duroi të gjitha keqbërjet, intrigat dhe padrejtësitë. Ai kurrë nuk u lodh dhe kurrë nuk u gjunjëzua. Përkundrazi, ishin jobesimtarët ata që u lodhën e u trishtuan, sepse fjalët e Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*) ishin të vërteta të padiskutueshme. Aq shumë u lodhën e u stresuan jobesimtarët nga prania e Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*) dhe nga mesazhi i tij paqësor, saqë vendosën ta ekzekutonin.

Por ishte urtësia e Allahut dhe fuqia e Tij që misioni të vazhdojë në Medinen e ndritur.

Pas mbërritjes në Medine, Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*) filloi të organizojë ndërtimin e një shoqërie të fortë islame, bazuar në pastërti dhe dije.



NDËRTIMI I XHAMISË

Xhamia ishte qendra e parë që ndërtoi Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*), kur mbërriti në Medine. Ajo xhami ishte qendra e adhurimit, e mësimi, e edukimit, e udhëheqjes dhe e drejtimit. Udhëheqja e Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*) nuk kishte vend të posaçëm, siç kanë sot udhëheqësit e shteteve nëpër botë, të cilët kanë pallatet e tyre presidenciale, apo vilat, apo sarajet e ndryshme. Vendudhëheqja e Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*) ishte xhamia. Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*) punoi vetë për ndërtimin e xhamisë, krah për krah myslimanëve. Pas ndërtimit të xhamisë, u ndërtuan dhomat e tij ngjitur me xhaminë.



VËLLAZËRIMI

Për të ndërtuar një shoqëri të pastër dhe të fortë, Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*) bëri vëllazërimin mes emigruesve (muhaxhirëve) dhe përkrahësve vendas (ensarëve). Ky veprim qartëson më së miri se feja e pastër islame është fe e paqes, e dashurisë, e vëllazërisë dhe e solidaritetit. Allahu i Madhëruar, në Kur'anin e shenjtë, thotë: **“Në të vërtetë, besimtarët janë vëllezër, andaj pajtojini vëllezërit tuaj midis tyre dhe kijeni frikë Allahun, në mënyrë që ju të mëshiroheni”**.⁷⁵

Me vëllazërimin mes besimtarëve, në Gadishullin Arabik u formua një shoqëri e re, larg dhunës e shtypjes. U formua një shoqëri, e cila sundohej nga harmonia, uniteti dhe respekti mes besimtarëve myslimanë. Ky vëllazërim shkatërroi ndasinë shtresore në fise e në ekonomi, duke vendosur si parim barazinë dhe drejtësinë shoqërore.

75 Sure “El-Huxhurat”, ajeti 10.



Kështu që në Medine u formua ajo shoqëri për të cilën Kur'ani i shenjtë thotë: **“Ju jeni populli më i mirë i dalë për njerëzimin: (sepse) ju urdhëroni që të bëhen vepra të mira, i ndaloni të këqijat dhe besoni Allahun”**.⁷⁶

Vëllazërimi u krye pas pesë apo tetë muajve të mbërritjes së Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*). Ai u tha myslimanëve: “Vëllazërohuni për hir të Allahut, dy e nga dy”. Pasi i vëllazëroi të gjithë myslimanët, mbeti Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*). Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*) i tha atij: “Unë të lashë ty për veten time. Ti je vëllai im dhe unë jam vëllai yt. Nëse dikush të përmend ty, i thuaj: ‘Unë jam rob i Allahut dhe vëllai i të Dërguarit të Tij’. Ai që e thotë këtë pas teje, është gënjeshtar. Betohem në Atë që më dërgoi me të vërtetën, se unë të kam zgjedhur ty për veten time. Ti je për mua në atë pozitë siç ishte Haruni për Musain, me përjashtim se nuk ka të dërguar pas meje. Ti je vëllai im dhe trashëgimtari im”.

Pastaj mori dorën e tij (Aliut) dhe tha: “Ky është vëllai im!” Kështu, Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*) bëri vëllazërim mes tij dhe Imam Aliut (*Paqja qoftë mbi të!*).

Të gjitha thëniet dhe veprat e Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*) janë

76 Sure “Al Imran”, ajeti 110.



mësim dhe edukim për mbarë njerëzimin, sepse ai nuk fliste nga vetja e tij, por thëniet e tij ishin shpallje e shpallur. Këtë e dëshmon edhe Kur'ani i shenjtë: **“Ai nuk flet sipas qejfit të vet, por ajo (që thotë) është vetëm shpallje hyjnore, që i vjen atij. Atë ia ka mësuar atij një (engjell) shumë i fuqishëm (Xhebraili)”**.⁷⁷

Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*) u mëson të gjithë njerëzve se te Allahu i Madhëruar nuk ka dallim mes të bardhit dhe të ziut, arabit dhe jo arabit. Ai thotë se dallimi i vetëm është devotshmëria. Këtë e dëshmon edhe Kur'ani i shenjtë: **“...Më i nderuari prej jush tek Allahu është ai që është më i devotshëm...”**⁷⁸

Për njëzet e tre vjet me radhë Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*) sakrifikoi në rrugën e edukimit dhe të mësimi. Gjithmonë këshillonte për vepra të mira. Falë mësimave dhe porosive të Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*), Islami u përhap dhe po përhapet në mbarë rruzullin tokësor. Dita-ditës Profeti ynë i dashur pushton zemrat e miliarda njerëzve, qofshin myslimanë apo jomyslimanë.

Që Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*) ishte mësues dhe edukues për mbarë

⁷⁷ Sure “En-Nexhm”, ajetet 3-5.

⁷⁸ Sure “El-Huxhurat”, ajeti 13.



njerëzimin, e dëshmon edhe Hytbeja e Lamtumurës, në të cilën ai u drejtohet të gjithë njerëzve.

Ja disa prej paragrafëve të Hytbes së Lamtumurës të Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*):

“... O njerëz, frikësojuni Zotit dhe respektojeni Atë, bëhuni të njerëzishëm dhe të drejtë ndaj të tjerëve! ... Vërtet, gjaku, nderi dhe pasuria janë të shenjta për ju, deri sa të takoheni me Krijuesin tuaj, ashtu siç është e shenjtë kjo ditë në këtë muaj dhe në këtë vend. Ruajuni, respektoni dhe nderoni vlerën e personalitetit! Njeriu është vepër madhështore e Allahut. Mjerë ai që e përçmon nderin dhe dinjitetin e veprës së Tij!

O njerëz, ju sigurisht do të ktheheni tek Allahu i Madhëruar dhe Ai do t’ju thërrasë të përgjigjeni për veprat dhe punën tuaj.

O njerëz, dijeni se ka përfunduar koha e padijes dhe e traditave të këqija, të cilat i kanë sjellë aq fatkeqësi gjinisë njerëzore. Unë ju kam treguar rrugën e shpëtimit, drejt të cilës duhet ecur. Sendet që ju janë dhënë amanet, ruajini si të ishin tuajat dhe kthejuani ato besnikërisht dhe me kohë atij që i përkasin. Gjakmarrja është e ndaluar...

... Respektojeni farefisninë. Përm bushni besnikërisht detyrat dhe detyrimet ndaj burrit dhe gruas, si dhe ndaj prindërve dhe fëmijëve! Ruhuni nga imoraliteti, tradhtia bashkëshortore dhe



xhelozia. Imoraliteti dhe tradhtia bashkëshortore janë gjynahe të rënda, ndërsa xhelozia sjell përçarje në martesë. Martohuni me ato që i doni, e kur Zoti, me vullnetin e Vet, do t'ju bashkojë, atëherë respektojeni dhe duajeni njëri-tjetrin dhe jetoni në dashuri e harmoni! O bashkëshortë, silluni ndaj grave tuaja me shumë mirësi dhe dashuri!

O njerëz, largohuni ngatërresave dhe përgojimit! Le të jenë të mallkuar në të dyja botët ata që u bëjnë shpifje grave të ndershme! ...Gratë tuaja janë dorëzuar në besë të Zotit; pra respektojeni këtë amanet të Zotit...

O njerëz, dini dhe mos harroni se të gjithë myslimanët janë vëllezër. Ju jeni plotësisht të barabartë në të drejta dhe në detyra. Arabi ndaj joarabit nuk ka kurrfarë përparësie e kjo vlen edhe për të ziun ndaj të bardhit, përveçse në devotshmëri. Të gjithë ju jeni pasardhësit e Ademit e Ademi është krijuar nga dheu.

O njerëz, kujdesuni për njëri-tjetrin, duajeni dhe ndihmoheni njëri-tjetrin! Mos guxoni ta fyeni apo ta grabitni njëri-tjetrin. Këto janë gjynahe të rënda. Merrni vetëm atë që ju jepet me dëshirë! Respektojeni pacenueshmërinë e pasurive tuaja, derisa të jeni në frymën e Ligjeve të Zotit... Kurrë mos e shkelni të drejtën dhe nderin e tjetrit! Mos i bëni dhunë vetes! Mos harroni se mëshira është një ndër themelet e Islamit!

O njerëz, dëgjoni se ç'po ju them dhe mbajeni mend mirë! Po ju lë Librin e Zotit, Kur'anin, të cilit, nëse i përmbaheni,



gjithnjë do t'ju ruajë që të mos e humbni rrugën e drejtësisë dhe të s'vërtetës. Kur'ani është libër i qartë dhe i shenjtë, vepër e vërtetë e Allahut dhe fjala e Tij, në vërtetësinë e të cilit nuk ka asnjë dyshim. Para vetes e keni tërë jetën time, të gjitha fjalët dhe veprat e mia, gjithçka që kam folur dhe kam punuar. Jam përpjekur të jenë në përputhje të plotë me urdhrat e Allahut. Nuk do të gaboni, nëse i përmbaheni Kur'anit (Librit të Zotit) dhe familjes time.

O njerëz, pas meje nuk do të vijë më i Dërguar tjetër nga Zoti dhe pas jush, populli nuk do të ketë më Pejgamber! Pra, bëni ibadet dhe adhuroni Zotin; agjëroni muajin e Ramazanit; jepni zekatin me zemër të plotë dhe të kënaqur dhe kryejeni Haxhin. Kështu, do të hyni në Xhenetin e Zotit të Madhëruar!

O njerëz, thoni gjithnjë të vërtetën e pastër! Asnjëherë të mos ju largojë urrejtja nga rruga e drejtë. Drejtësia është motra e devotshmërisë. Frikësojuni Allahut se Ai i sheh mirë veprimet tuaja!

O njerëz, e dëgjuat porosinë time. Atëherë, futeni atë në zemrën dhe në jetën tuaj! Të gjithë ata që i dëgjuan fjalët e mia, le t'ua përcjellin atyre që nuk i kanë dëgjuar se ndodh që ata i kuptojnë më mirë.

O Zoti im, a e përmbusha detyrën dhe misionin e besuar?" Mbi njëqind mijë haxhinj folën njëzëri: 'O i Dërguari i Zotit, ti e përmbushe misionin tënd me besnikëri dhe na e komunikove atë që të urdhëroi Zoti...' Atëherë, Profeti Muhamed (Paqja e bekimi i



Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!) tha: “O Zot, dëshmo! O Zot, dëshmo! O Zot, dëshmo!”

Atë ditë iu shpall ajeti nga Zoti i Lartësuar: **“Sot kam përsosur fenë tuaj, plotësova dhuntinë time për ju dhe jam i kënaqur që Islami të jetë feja juaj”**.⁷⁹

Sa të mrekullueshme këto porosi! Vërtet, ato janë shkolla më e mirë e edukimit dhe e mësimit për mbarë njerëzit, pa dallim kombi, gjuhe, race e feje. Duke lexuar porositë e kësaj hytbeje madhështore, themi me plot bindje se Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*) është mësuesi dhe edukuesi i mbarë popujve, edhe pse shumica e tyre nuk e shfaqin. Fjalët e kësaj hytbeje të begatë janë receta më e përkryer për mbarëvajtjen e jetës së njeriut, në të gjitha aspektet e jetës së tij.

Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*) ka qenë vetë Kur’ani, sepse i gjithë Kur’ani ishte kristalizuar në vetë qenien e tij. Kur ecte, kur fliste, e ndriçonte çdo gjë me dritën e Kur’anit.

Bernard Show, në librin e tij për Muhamedin thotë: “Gjithmonë e kam vlerësuar shumë besimin e Muhamedit, thjesht për forcën e tij të jashtëzakonshme. Mendimi im është se Islami është besimi i vetëm i aftë, për të drejtuar në

79 Sure “El-Maide”, ajeti 3.



mënyrë të suksesshme ndryshimet e shumta në jetë. Jam i bindur se, nëse i njëjti person, do të ishte përballur me problemet e sotme, ai do t'i kishte zgjidhur ato me sukses, duke i sjellë njerëzimit paqe dhe lumturinë e nevojshme. Parashikoj që besimi i Muhamedit do të pranohet në Evropën e të nesërme, siç ka filluar të pranohet në Evropën e sotme".⁸⁰

O Zoti ynë! Na mundëso të jemi në gjurmët e Profetit Muhamed (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!) në këtë jetë dhe na dhuro shefatin e tij në Jetën Tjetër!

⁸⁰ "The Genuine Islam", Singapore, vol. 1, Nr. 8, 1936.



PROFETI MUHAMED

(Paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!),

IDËRGJUARI PËR MBARË NJERËZIMIN

Allahu i Madhëruar thotë në Kur'anin e shenjtë:
“Muhamedi nuk është babai i askujt prej burrave tuaj, por është i Dërguari i Allahut dhe vula e profetëve; Allahu është I Gjithëdijshtëm për çdo gjë”.⁸¹

Askush nuk ka personalitet më të lartë se ai i burrit më të madh e më të përkryer, Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*).

Në të gjitha kohët nuk ka jetuar personalitet i lartë si ky, i cili bëri ndryshime rrënjësore e të gjera në historinë e njerëzimit. Qytetërimi që solli Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*) vazhdon të ushqejë mbarë botën, me njohje dhe dije për shekuj të tërë dhe do të vazhdojë deri në fund të kësaj bote.

Doktor Maikëll Hart, profesor i matematikës, i astronomisë dhe i fizikës në Universitetin amerikan, si dhe

81 Sure “El-Ahzab”, ajeti 40.



specialist në grupin kozmik amerikan, thotë: “E zgjedha Muhamedin të parin në listë dhe shumë njerëz kanë të drejtë të çuditen me këtë zgjedhje. Mirëpo Muhamedi është njeriu i vetëm në histori, i cili korri sukses të plotë, qoftë nga ana fetare, qoftë ajo jetësore. Ai ftoi në Islam dhe e përhapri atë si një ndër fetë më madhështore. Ai ishte udhëheqës politik, ushtarak dhe fetar. Pas kalimit të 13 shekujve nga vdekja e tij, gjurmët dhe ndikimet e Muhamedit vazhdojnë të jenë të forta dhe ringjallëse”.

Madhështia e Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*) duket shumë qartë në ndryshimin e madh që bëri në Gadishullin Arabik, duke e nxjerrë atë nga skëtërrat e injorancës dhe paganizmit në dritën e monoteizmit.

Sipas transmetimeve të ndryshme islame, data 27 e muajt Rexheb është dita e zbritjes së kurorës së profetësisë të Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*), të cilin Allahu e ka dërguar për mbarë njerëzimin.

Gjithashtu, në disa transmetime të tjera thuhet se me këtë datë ka ndodhur ndodhia madhështore e Israsë dhe e Mi'raxhit. Këtë ndodhi e përmend edhe Kur'ani i shenjtë, pikërisht në Suren “Isra”, ajeti 1, ku thuhet: **“I lavdëruar qoftë Ai që e mbarti robin e Tij (Muhamedin) natën nga Xhamia e Shenjtë (në Mekë) në Xhaminë e Largët (të Jerusalemit), rrethinën e të cilës e kemi bekuar, për t'i**



treguar atij disa nga mrekullitë Tona. Ai, me të vërtetë, dëgjon çdo gjë dhe sheh çdo gjë”.

Sido që të jetë, të dyja këto ndodhi janë madhështore dhe kanë lidhje me njeriun madhështor, Profetin Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*).

Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “*Allahu e dërgoi atë (Profetin Muhamed (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!)), kur njerëzit ishin në humbje e në çoroditje, të zhytur në përçarje e në shkatërrim, të magjepsur me unin dhe lakminë... Profeti porositi shumë dhe udhëhoqi rrugën, duke i ftuar me urtësi e këshillë të mirë*”. (Nehxhul Belaga)

Që Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*) është i Dërguari për mbarë njerëzimin, e dëshmon mrekullia e tij e përjetshme, Kur’ani fisnik. Përderisa kjo shpallje është për mbarë njerëzimin, atëherë a nuk është sjellësi, sqaruesi dhe përcjellësi i saj udhëheqës për mbarë njerëzimin?

Në Kur’an ka disa ajete që flasin qartë se Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*) është i Dërguar për të gjithë njerëzit; siç është ajeti 185 i sures “El-Bekare”; ajeti 41 i sures “Ez-Zumer”; ajeti 170 dhe 174 i sures “En-Nisa”; ajeti 57 dhe 108 i sures “Junus”. Po citojmë pesë prej tyre.



Ajeti i parë: Allahu i Madhëruar thotë: **“Thuaj (o Muhamed): ‘O njerëz, unë jam i Dërguari i Allahut për të gjithë ju, i Atij që i përket sundimi i qiejve dhe i Tokës. Nuk ka zot tjetër të vërtetë veç Atij; Ai jep jetë dhe vdekje, prandaj besoni në Allahun dhe në të Dërguarin e Tij, Profetin që nuk di shkrim e lexim e që beson në Allahun dhe fjalët e Tij! Shkoni pas Tij, që të jeni në rrugën e drejtë!’”**⁸²

Në një transmetim të ardhur nga Imam Hasani (*Paqja qoftë mbi të!*), i cili flet për shkakun e zbritjes së këtij ajeti, thuhet: “Disa jehudij shkuan te Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*) dhe i thanë: “O Muhamed. Ti je ai që thua se je i Dërguari i Allahut dhe të është shpallur Shpallja njëlloj si Musait, të birit të Imranit?”

Profeti heshti për pak kohë, pastaj tha: “Po. Unë jam zotëria i bijve të Ademit dhe nuk e them për mburrje. Unë jam vula e profetëve, udhëheqësi i të devotshmëve dhe i dërguari i Zotit të botëve”.

Ata e pyetën përsëri: “Për kë je dërguar? Për arabët, për joarabët apo për ne”.

82 Sure “El-A’raf”, ajeti 158.



Atëherë, Allahu zbriti ajetin e parë, të mësipërm, që sqaron se ai është i Dërguar për mbarë njerëzit.

Ajeti i parë: **“Thuaj (o Muhamed): “O njerëz, unë jam i Dërguari i Allahut për të gjithë ju”,** u drejtohet të gjithë njerëzve, të çdo kohe dhe vendi, të çdo kombi e kombësie, pa dallim race e ngjyre, për ata që ishin të pranishëm në kohën e zbritjes së ajetit dhe për ata që janë dhe do të vijnë.

Prandaj, ky është urdhër i Allahut të Madhëruar, që të gjithë njerëzit ta ndjekin Profetin Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*), sepse Allahu e dërgoi atë për mbarë njerëzimin. Pa dyshim, që ky është dallimi i Profetit Muhamed nga profetët e tjerë. Allahu nuk pati dërguar më parë asnjë profet për mbarë njerëzimin. A

*Ajeti i dytë: “I lartësuar qoftë Ai që i ka zbritur Dalluesin robit të Vet, që të jetë paralajmërues për botët”.*⁸³

Në këtë ajet, Allahu i Madhëruar e ka cilësuar Profetin Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*) “rob të Tij”. Në të vërtetë, ky është “medaljon nderi” për Profetin, sepse Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*) është rob i Allahut dhe

83 Sure “El-Furkan”, ajeti 1.



jo rob i vetes së tij. Ai ka qenë sundues dhe kontrollues i vetes së vet. Ai, që me të vërtetë është rob i Allahut, është sundues dhe kontrollues i vetes së tij. I tillë ishte Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*) dhe për këtë iu shpall Dalluesi (Kur'ani) dhe për këtë është edhe paralajmërues për të gjitha botët. Që Profeti Muhamed është “rob i Allahut” dhe “paralajmërues për botët”, nënkupton se ai nuk ka qenë i veçantë për një popull apo racë, apo vend.

Ai është i pastër nga damarët e racizmit dhe të fanatizmit verbues. Ai qëndron mbi arabizmin e joarabizmin. Ai ka thënë: “Nuk ka dallim mes arabit dhe joarabit, veçse me devotshmëri”.

Në Kur'an nuk lexojmë që Allahu ta këtë cilësuar Profetin Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*) si arab, por e ka cilësuar si rob dhe të Dërguar të Allahut. Është e ditur që Profeti Musa dhe Profeti Isai ishin prej bijve të Izraelit, mirëpo në Kur'an nuk gjejmë që ata të cilësohen si izraelit.

Gjithashtu, as Profeti Nuh nuk cilësohet në Kur'an si Asirian (sirianit). Kjo për faktin se profetët janë më të lartit, më fisnikët që t'i kufizojë kombësia, vendi apo krahina. Pa dyshim që Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*) ishte njeri, siç thotë Kur'ani: **“Thuaj, unë jam njeri si ju”** dhe u dërgua për shpëtimin e



njerëzimit. Sheriati i tij është për të gjithë njerëzit dhe nuk është i veçantë për një komb. Sheriati i tij nuk është as lindor e as perëndimor, por është mbarëbotëror.

Ajeti i tretë: “Ky Kur’an më është shpallur, në mënyrë që nëpërmjet tij t’ju tërheq vërejtjen juve dhe kujtdo që i përcillet...”⁸⁴

Ky Kur’an, nuk mund të jetë krijimtari e mendjes njerëzore. Ky Kur’an përmban dëshmi të shumta rreth mrekullisë së tij, sepse fjalët dhe kuptimet e tij janë mrekulli. Ky Kur’an, që sqaron çdo gjë, është i përherëshëm deri në ditën e fundit të kësaj jete. Ai është Libri i Allahut dhe dëshmuesi i profecisë së Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*).

Ky ajet konstaton se Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*) është dërguar për të gjithë ata që u mbërrin Kur’ani. Kjo përfshin të gjithë njerëzit, deri në ditën e fundit të kësaj bote. Në disa hadithe lexojmë se kuptimi i përcjelljes së Kur’anit nuk është vetëm me mbërritjen e tekstit origjinal, por ky kuptim përfshin edhe përkthimin e tij në gjuhët e popujve. E kanë pyetur

84 Sure “El-En’am”, ajeti 19.



Imam Sadikun (Paqja qoftë mbi të!) për kuptimin e këtij ajeti dhe ai është përgjigjur: “Me të gjitha gjuhët”.⁸⁵

Ajeti i katërt: “Ne të kemi dërguar ty (o Muhamed) vetëm si sjellës të lajmit të mirë dhe paralajmërues për të gjithë njerëzimin, por shumica e njerëzve nuk dinë”.

Ky ajet flet për natyrën e përgjithshme të mesazhit të Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*) dhe të qenurit e tij Profet për të gjithë njerëzit. Në një hadith të transmetuar nga Ibn Abasi, të cilin e përmendin komentuesit për këtë ajet, Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*) ka thënë: “Më janë dhënë pesë dhe nuk e them për krenari. Jam dërguar për të kuqtë dhe të zinjët. Toka më është bërë mua vend pastrimi dhe vendfaljeje... dhe më është dhënë shefati, që do ta zbatoj për umetin tim, në Ditën e Kiametit”.⁸⁶

*Ajeti i pestë: “Dhe Ne nuk të kemi dërguar ty (o Muhamed), veçse si mëshirë për botët”.*⁸⁷

Ky ajet e dëshmon dhe e përforcon akoma më shumë që Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*) është i Dërguar për mbarë njerëzimin.

85 Tesiri “Burhan”, fundi i komentimit të ajetit në fjalë. Tefsiri “Nuru Thakalejn”, vëll. 1, f. 707.

86 Tefsiri “Maxhmeul Bejan”, vëll. 8, f. 391.

87 Sure “El-Enbija”, ajeti 107.



Dihet se mëshira është prej cilësive të Allahut dhe përfshin çdo gjë. Ky cilësim i Profetit, me cilësinë e mëshirës, pa dyshim që është argumentues se ai është më i larti dhe më fisniku i profetëve. Mëshira e tij në këtë jetë përfshin të gjithë njerëzit, qofshin besimtarë apo jobesimtarë. Kjo për faktin se ai solli dhe përhap fenë shpëtuese për mbarë njerëzimin. Nëse gjenden njerëz që nuk përfitojnë prej kësaj feje, kjo ka lidhje me vetë ata dhe nuk e cenon natyrën e përgjithshme të mëshirës.

Kjo është njësoj sikur të ndërtohet një spital i pajisur me të gjitha aparaturat për shërimin e sëmundjeve të ndryshme dhe në të ka doktorë, specialistë dhe të aftë, ka ilaçe të ndryshme dhe dyert e këtij spitali janë të hapura për të gjithë njerëzit, pa dallim. Vallë, a nuk është ky spital mëshirë për të gjithë njerëzit? Nëse disa njerëz nuk shkojnë në të, për shkak të kokëfortësisë së tyre, kjo nuk ndikon në ekzistencën e këtij spitali i përgjithshëm.

Fraza “*lil alemijne*” për botët, ka kuptim të gjerë dhe i përfshin të gjithë njerëzit, në çdo kohë dhe në çdo vend. Ky ajet tregon dhe argumenton se Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*) është mëshirë dhe model për të gjithë njerëzit, deri në Ditën e Kiametit.

Në tefsirin e Kurtubiut thuhet se kuptimi i thënies së Allahut në këtë ajet “*lil alemijne*”- “*për botët*”, është për



njerëzit dhe për xhindet, sepse Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*) ka qenë i dërguar dhe paralajmërues për njerëzit dhe për xhindet. Ai është vula e profetëve dhe mesazhi i tij është për të gjithë njerëzit...⁸⁸

Në këtë jetë të mbushur me shthurje, devijime nga të gjitha anët. Në këtë jetë, ku njerëzit janë të zhytur në padrejtësi, degjenerim moral etj, del në pah më së miri kuptimi që Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*) është mëshirë për të gjitha botët. A ka mëshirë më të madhe se ai që solli fenë, e cila, nëse zbatohet dhe praktikohet, do të zhdukë të gjitha fatkeqësitë, vështirësitë, devijimet, shthurjet... etj?

Allahu i Madhëruar thotë: **“Kush kërkon tjetër fe përveç Islamit, nuk do t’i pranohet dhe ai në Botën Tjetër do të jetë i humbur”.**⁸⁹

“Allahu është Ai që e ka çuar të Dërguarin e Vet me udhërrëfimin dhe fenë e të Vërtetës, për ta ngritur atë më lart se të gjitha fetë, edhe nëse nuk e pëlqejnë idhujtarët”.⁹⁰

Në Kur’anin e shenjtë, që është mrekullia e përjetshme e Allahut për Profetin Muhamed (*Paqja e bekimi*

88 Xhamiu Ahkamil Kur’anil Kerijm, vëll. 13, f. 6.

89 Sure “Al Imran”, ajeti 85.

90 Sure “Saf”, ajeti 9.



i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!), lexojmë se Profeti Isa ka lajmëruar ardhjen e vulës së profetëve, Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*). Në suren “Saf”, në ajetin 6 thuhet: **“Kujto kur Isai, i biri i Merjemes, tha: ‘O bijtë e Izraelit, unë jam i dërguari i Allahut tek ju, për t’ju vërtetuar Teuratin e shpallur para meje dhe për t’ju sjellë lajmin e gëzueshëm për një të dërguar, emri i të cilit është Ahmed, që do të vijë pas meje’. Por, kur ai u solli atyre shenja të qarta, ata thanë: ‘Kjo është magji e hapur!’”**

Një tjetër argument që tregon se Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*) është udhëheqës për mbarë njerëzinë është edhe përmbajtja e Hytbes së Lamtumirës. Nga fillimi e deri në fund të kësaj hytbeje, Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*) ka thënë “O ju njerëz”, pra u drejtohet të gjithë njerëzve dhe nuk ka thënë “O ju myslimanë”, ose “O ju që keni besuar”.

Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*) është drita e pashuar. Suneti i tij i bekuar është receta më e mirë shëruese për çdo sëmundje shpirtërore për të gjithë njerëzit.

Do ta mbyllja këtë artikull me thënien e Allahut të Madhëruar: **“O Profet! Ne të kemi dërguar ty si dëshmitar, sjellës të lajmit të mirë dhe paralajmërues; njëkohësisht**



(të kemi çuar) **si thirrës, që i fton njerëzit në rrugën e Allahut me urdhrin e Tij dhe si pishtar ndriçues**".⁹¹

Këto dy ajete na sqarojnë më së miri dërgimin e Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*).

Në këto data të shënuara, ne duhet të bëjmë llogarinë e vetes sonë e të themi: A jemi në gjurmët e Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*)? Sa është i pranishëm Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*) në zemrat tona, në mendjet tona dhe në sjelljet tona? A ndriçohemi nga drita e tij e pashuar? A jemi të veshur me moralin e Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*)? Në këto ditë, sigurisht në çdo ditë e në çdo çast, t'i lutemi Allahut të Madhëruar, që të na forcojë besimin dhe të na bëjë prej ndjekësve të Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*) në këtë jetë dhe të na bashkojë me të në Jetën Tjetër!

⁹¹Sure "El-Ahzab", ajetet 45-46.



“VËRTET, TEK I DËRGUARI I ALLAHUT JU KENI SHEMBULLIN MË TË LARTË”⁹²

Të gjitha falënderimet dhe lavdërimet janë për Krijuesin tonë të Përsosur, Allahun e Madhëruar, i Cili është Një dhe i Vetëm e që mbizotëron gjithkënd e gjithçka. Paqja dhe mëshira e Allahut qoftë mbi më të zgjedhurin e krijesave, mbi ndriçuesin e njerëzimit, mbi atë shpirt të dëlirë dhe fisnik, mbi atë dritë të pashuar. Paqja dhe mëshira e Allahut qoftë mbi familjen e bekuar të Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*), mbi shokët e tij të nderuar dhe mbi të gjithë ata që ndjekin rrugën e tij deri në Ditën e Fundit! Paqja dhe mëshira e Allahut qoftë mbi të gjithë të dërguarit e Tij!

S’ka dyshim se Allahu është burimi i udhëzimit të drejtë e të vërtetë. Allahu ka vendosur në natyrshmërinë e lindur të besimit (*fitreh*), dashurinë dhe pasionin për të arritur përsosmërinë. Por njeriu nuk është i sigurt prej

92 Sure “El-Ahzab”, ajeti 21.



sundimit të zemërimit e të epshit. Për këtë, përveç arsyes dhe mjeteve të tjera të njohjes, Allahu zgjodhi në mesin e njerëzve të dërguarit, të cilët mbajtën mbi supe peshën e rëndë për t'i ftuar njerëzit drejt të Vërtetës dhe Udhëzimit të pakundërshtueshëm.

Në asnjë kohë Allahu nuk i ka lënë njerëzit pa udhëzues, ndriçues e udhërrëfyes. Edhe argumentet logjike e miratojnë faktin se në asnjë kohë Toka nuk do të qëndrojë pa argument, me qëllim që njerëzit të mos kenë arsye për t'u shfajësuar para Allahut të Madhëruar. Argumenti ka ekzistuar para krijesave, me krijesat dhe pas krijesave. Sikur mbi Tokë të ngeleshin vetëm dy njerëz, njëri prej tyre do të ishte argument për tjetrin. Të dërguarit e Allahut dhe eulijatë e Tij morën përsipër udhëzimin, me të gjitha fazat e tij, duke sakrifikuar çdo gjë. E përse e gjitha kjo? Mos vallë për të fituar post a famë? Jo! Këtë e bënë vetëm për t'i shërbyer njerëzimit, për ta nxjerrë atë prej errësirave në dritën e vërtetë e të pashuar.

Të gjithë të dërguarit e Allahut kanë qenë në shërbim të njerëzimit, mirëpo Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*) ka qenë më i përkushtuari prej tyre. Ai ka qenë më i përsosuri dhe vula e tyre. Pas tij nuk vjen i dërguar, siç e dëshmon Kur'ani famëlartë në suren "El-Ahzab", në ajetin 40: ***"Muhamedi nuk ka qenë baba i asnjërit prej burrave tuaj, por i Dërguari i Allahut dhe vula e të dërguarve"***.



KUSH ËSHTË PROFETI MUHAMED

(Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!)?

Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*) nuk është i panjohur, që të ketë nevojë për njohje. Ai është më i njohuri i njerëzve që ka parë bota, që kur u bë e përshtatshme për jetesë. Mirëpo, ai nuk është njohur ashtu siç i takon, për arsye se mendja e njeriut nuk ka arritur në atë lartësi, që të mund të kuptojë pozitën e këtij personaliteti të përsosur e udhërrëfyes për njerëzimin.

A ka mundësi që një person të jetë në gjendje ta kuptojë atë, i cili arriti në majat e përsosmërisë njerëzore? Ata që thonë se Muhamedi (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*) është njeriu “më i përsosur” dhe udhërrëfyes i njerëzisë, a e kuptojnë thelbin e fjalës “më i përsosuri”?

S’ka dyshim se njohja e Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*) plotëson dhe ndriçon mendjet e njerëzve. Të shumta janë kërkimet dhe studimet e studiuesve për jetën e Profetit Muhamed (*Paqja e*



bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!), duke filluar që në kohën e tij e duke ardhur në ditët e sotme, çka do të vazhdojë, pa dyshim edhe në të ardhmen.

Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*) nuk i përket vetëm një kombi a bashkësie e as një kontinenti; ai është i Dërguar për të gjithë njerëzimin. Ai nuk është vetëm për myslimanët; ai është për gjithë njerëzimin, siç e vërteton Kur'ani famëlartë: **“Ne të dërguam ty për të gjithë njerëzit”**.⁹³

Cilido që studion jetën e Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*), si dhe mesazhin që ai solli, do të shohë se edhe kombet e tjera, joislame, janë lumturuar me Profetin Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*) ashtu si myslimanët.

Sheriati që solli Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*) është mishëruar plotësisht me ligjet e jetës. Para ardhjes së Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*) bota ishte trup pa shpirt dhe në errësirë; ai solli shpirtin për botën dhe dritën për tokën e errësuar. S'ka dyshim se vetë Muhamedi (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*) është shpirti dhe dielli i botës, me anë të të cilit ndriçohet mendja njerëzore. Po të mos ishte Profeti

93 Sure “Sebe”, ajeti 27.



Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*) dhe Sheriati i tij, në këtë botë nuk do të shihej gjë tjetër veçse shtypje, padrejtësi, degradim; nuk do të shihej lumturi e begati, as individuale, as shoqërore.

Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*) i ftonte njerëzit të dija, edhe pse vetë ishte i pashkolluar. A është parë, që një i pashkollë të luftojë injorancën? Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*) nuk studioi në universitete, nuk mori mësim nga mësues, nuk mori pjesë në simpoziume shkencore e as nuk u rrit në mjedise dijeje. Përkundrazi, ai u rrit në një shoqëri, të cilën e kishte mbuluar padituria, hija e fanatizmit dhe e mendjemadhësisë.

Ky “i pashkolluar” është vetë mrekullia: mrekulli në diturinë e tij; mrekulli në virtytet e tij; mrekulli në mendimet e tij; mrekulli në faljen e tij; mrekulli në urtësinë e tij; mrekulli në trimërinë e tij; mrekulli në cilësitë dhe përsosmërinë e tij. Sa të pafundme janë mrekullitë në këtë personalitet kaq të madh! Allahu Fuqiplotë, në Kur’anin famëlartë thotë: **“Vërtet, tek i Dërguari i Allahut ju keni shembullin më të lartë”**.⁹⁴

94 Sure “El-Ahzab”, ajeti 21.



PROFETI MUHAMED

(Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!)

MËSHIRË PËR KRIJESAT

Gabon rëndë ai që thotë se feja islame është përhapur me gjuhën e shpatës, sepse po të studiojmë Kur'anin fisnik, do të gjejmë se:

Së pari: Dhuna nuk është e pranueshme në fe, siç thotë vetë Allahu i Madhëruar: **“Në fe nuk ka dhunë...”**⁹⁵

“Fto në rrugën e Zotit Tënd me urtësi dhe porosi të përkryera”.⁹⁶

Së dyti: Është më se e qartë se fitimi i zemrave nëpërmjet dhunës është i pamundur; zemrat fitohen me urtësi, dashamirësi dhe këshillë.

Nëse i hedhim një vështrim jetës së Profetit Muhamed *(Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e*

95 Sure “El-Bekare”, ajeti 256.

96 Sure “En-Nahl”, ajeti 125.



tij!), do të shohim se veprimi i parë që ai kreu, ishte pastrimi dhe edukimi i zemrave. E, ky veprim është i pamundur të arrihet me anë të dhunës dhe forcës. Arma më e fortë për mposhtjen e armiqve, ishte morali i lartë dhe mëshira e gjerë. Për këtë, Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*) u quajt “profeti i mëshirës” për të afërmit dhe për të largët, për miqtë dhe për armiqtë.

Allahu thotë në Kur’an: **“Ne të dërguam ty mëshirë për të gjitha krijesat”.**⁹⁷

Ai i kishte të gjitha mundësitë të përdorte dhunën, kur ishte në Mekë. Sikur t’i kishte urdhëruar shokët e tij për të vrrarë kundërshtarët e tij, në një natë ai do ta kishte arritur këtë. Dhe, nëse do ta kishte bërë këtë, nuk do shijonte fatkeqësitë që i erdhën prej tyre, sepse drejtuesit e keqbërësve ishin sa numri i gishtërinjve; por ai nuk e bëri këtë, sepse ishte Profet i mëshirës. Ai, kurrë, nuk e ka ngritur shpatën mbi ata, përveçse kur ata i ngritën shpatat kundër tij. Nëse do të kishte përdorur gjuhën e forcës, nuk do të ishte ky numër kaq i madh pasuesish të tij. Këtë e dëshmon edhe Kur’ani fisnik, i cili thotë: **“Ti ishe i butë ndaj tyre, e Allahu të dhuroi mëshirë; sikur të ishe i vrazhdë e zemërfortë, ata do të largoheshin nga ti...”**⁹⁸

97 Sure “El-Enbija”, ajeti 107.

98 Sure “Al Imran”, ajeti 159.



Po ta lexojmë dhe ta studiojmë jetëshkrimin e Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*), do të gjejmë shumë ndodhi armiqësore, të cilave ai u është kundërpërgjigjur me butësi e mëshirë. Ndër ato ndodhi përmendim: Një grua jehudite donte ta helmonte Profetin Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*) dhe për këtë ajo e ftoi për gosti në shtëpinë e saj, së bashku me disa shokë të tij. Por, Allahu i Madhëruar e mbrojti prej këtij kurthi. Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*) e fali atë grua dhe nuk e ndëshkoi. Ndjenja e thellë e mëshirës që shihej tek ai, u shfaq në kohën e çlirimit të Mekës, i cili tha atë thënie të përsosur, kur mekasit e pyetën se çfarë do të ndodhte me ta në këtë kohë. Ai u tha atyre: “Shkoni, ju jeni të lirë!”

Mendoni të nderuar lexues, a ka në rruzullin tokësor njeri, sado i njohur të jetë, që t’u thotë armiqve të tij më të ashpër, atyre që e torturuan, e poshtëruan, e luftuan për njëzet e tre vjet me radhë, “ju jeni të lirë!”? Ky është Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*). Atij nuk i ngjason askush.

A nuk duhet të respektohet atëherë ky personalitet? A nuk duhet të ndiqen këshillat dhe porositë e tij? Sigurisht që po, sepse në dashurinë, respektin dhe ndjekjen e tij ka kënaqësi dhe qetësi për zemrat. E, më shumë se kaq, në dashurinë dhe në ndjekjen e rrugës së tij, është kënaqësia e



Allahut të Madhëruar. Kur'anî fisnik thotë: **“Thuaj: ‘më ndiqni mua e Allahu t’ju dojë ju’”**.⁹⁹

Përderisa udhëheqësi i kësaj feje është i tillë, atëherë si do të jetë vallë feja e tij? S’ka dyshim se feja e tij është fe e paqes, e mëshirës, e faljes, e vëllazërimit, e bujarisë. Në fenë islame nuk ekziston urrejtja e padrejtësia, as poshtërimi e pabarazia, sepse Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*) ishte ai që zhdukuri ndjenjën e urrejtjes, të padrejtësinë, poshtërimin e pabarazinë.

Në një hadith thuhet: *“Nuk ka dallim mes arabit e joarabit, përveçse me devotshmëri”*. Ishte Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*) ai që vendosi drejtësinë, ai që vendosi të drejtat e gruas, se ajo është njeri si burri. Ishte Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*) ai që i porosiste prijësit e ushtrive, para se të niseshin për në betejë: *“Mos vrisni të moshuarit, as fëmijët e as gratë! Mos i prisni pemët! Mos i masakroni të plagosurit! Mos digjni shtëpitë e mos i plaçkitni ato...!”*

Ky është Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*) dhe kjo është feja e tij, e cila e ndalon rreptësisht vrasjen dhe gjakderdhjen. Kur'anî fisnik thotë: **“... Ai që vret një njeri që nuk ka vrarë e as nuk ka**

⁹⁹ Sure “Al Imran”, ajeti 31.



bërë shkatërrim, është njëlloj sikur të kishte vrrarë të gjithë njerëzit...”¹⁰⁰

Feja islame është fe e paqes. Këtë e shohim që në takimin e parë mes myslimanëve, të cilët përshëndeten me *“selam alejkum!”* - *“paqja qoftë mbi ju”*. Por, nëse themi se Islami e ligjëron xhihadin, kjo nuk nënkupton se Islami është fe e dhunës, sepse në jurisprudencën islame sqarohen më së miri kushtet e kësaj çështjeje.

Prandaj, ftojmë të gjithë ata, që hedhin akuza mbi këtë fe të pastër që ta studiojnë - sa më mirë dhe larg fanatizmit interesit, - kushtetutën bazë të kësaj feje, Kur'anin fisnik, si dhe jetën e të Dërguarit të Allahut, vulës së profetësisë, Profetin Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*) e pastaj të nxjerrin përfundimet e tyre. Allahu i Madhëruar thotë në Kur'an: **“Thuaj: ‘Punoni, se Allahu, i Dërguari i Tij dhe besimtarët do të shohin punën tuaj’”**.¹⁰¹

100 Sure “El-Maide”, ajeti 32.

101 Sure “Et-Teube”, ajeti 105.



DITËLINDJA E PROFETIT MUHAMED - DITA E UNITETIT ISLAM

Ditëlindja e Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*) është dita e unitetit të myslimanëve. Në këtë ditë, myslimanët në mbarë botën jo vetëm festojnë ditën e lindjes së Profetit Muhamed, por edhe nxjerrin mësim për të ardhmen e tyre, duke u bazuar në Kur'anin fisnik dhe në thëniet e porositë të Dërguarit të Allahut të Madhëruar.

Në Kur'an thuhet: **“Ato çka ju jep i Dërguari, merrini dhe për ato që ju ndalon, ndaluni!”**¹⁰²

Por, nuk mjafton që Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*) të përkujtohet një herë apo dy herë në vit. Ai nuk ndodhet në mesin tonë trupërisht, por është mrekullia e tij e përhershme, Kur'ani, si edhe hadithi i tij. Ata janë frymëzues për çdo njeri. Kur'ani dhe hadithi janë të pandarë nga njëri-tjetri. Argument më se

102 Sure “El-Hashr”, ajeti 7.



i qartë i këtij uniteti, është dëshmia e myslimanit, shehadeti: “*Eshhedu en la ilahe il-lAll’lrah ue eshhedu en-ne Muhameden resulullah* – “Dëshmoj se nuk ka të adhuruar tjetër pos Allahut dhe dëshmoj se Muhamedi është rob dhe i dërguar i tij”. Dëshmia thotë se zemrat e myslimanëve janë të drejtuara dhe të bashkuara në besimin tek Allahu dhe tek i Dërguari i Tij.

Në këtë ditë të madhe, të gjithë myslimanët njihen me sakrificat e Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*) për bashkimin e zemrave dhe përgatiten për t’i bërë ballë çdo kundërvënieje që mund t’u vijë atyre, ashtu siç u bënte ballë Profeti. Jo më kot, Allahu na urdhëron e na thotë se te Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*) ne gjejmë shembullin më të lartë, sepse ai është shembull për moralin: **“Vërtet, ti je në majat më të larta të moralit”**.¹⁰³

Ai është shembull i lartë në gjithçka. Me atë shembull të lartë –thotë Zoti për Profetin, - ai arriti të bëjë bashkimin e zemrave. E, zemrat e myslimanëve duhet të jenë të bashkuara dhe të kenë si qëllim vetëm një gjë, Islamin. Allahu thotë në Kur’an: **“Kapuni pas fesë së Allahut e mos u ndani”**.¹⁰⁴

Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*), ishte njëkohësisht prind, baba e

103 Sure “Kalem”, ajeti 4.

104 Surja “Al Imran”, ajeti 103.



udhëheqës i një bashkësie dhe shpallës i një feje mbarëbotërore e pa dyshim, nuk mund të ishte mospërfillës ndaj së ardhmes dhe mirëqenies së umetit (bashkësisë) të tij. Përkundrazi, gjithçka që ka të bëjë me umetin: zhvillimi, arsimimi, detyrimet dhe të drejtat, ishin të një rëndësie të veçantë për të. Kur'ani i shenjtë dhe Suneti (tradita profetike) janë plot me referime për çështjet që lidhen me umetin dhe Sheriatin. Ato përmbajnë shumë urdhëresa, të cilat përcaktojnë detyrimet dhe përgjegjësitë që ka çdo individ. Suneti i Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*) përmban një mori elementesh, që lidhen me mbrojtjen, jo vetëm të shoqërisë myslimane, por të mbarë shoqërisë njerëzore. Sheriati që solli Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*) është i mishëruar në ligjet e jetës.

Jeta e Profetit të nderuar është shembulli më i mirë për të gjithë. Është shembull si udhëheqës fetar. Është shembull si udhëheqës shteti. Është shembull si prind e si bashkëshort.

Është shembull për ata që dëshirojnë të fitojnë dashurinë dhe kënaqësinë e Zotit. Është shembull për ata, që, edhe pse kanë pasuri, falënderojnë Allahun dhe dinë të jenë të thjeshtë. Është shembulli i durimit dhe i mbështetjes tek Allahu në kohë dhe situata të vështira. Është shembulli i zemërgjerësisë dhe i bujarisë. Është shembulli i mëshirës



ndaj familjes, ndaj të dobëtëve, jetimëve, robërve të luftës etj. Është shembulli i faljes dhe i tolerancës ndaj gjynahqarëve.

Nëse dëshiron të mbrosh drejtësinë, të thërrasësh për drejtësi, ta ngresh lart atë, atëherë shih jetën e Profetit të nderuar në Mekë, kur ai nuk kishte asnjë ndihmës dhe i thërriste politeistët në shpëtim, duke u shpallur të vërtetën. Ai është një udhërrëfyes: me anë të traditës së tij mund t'i korrigjosh të gjitha gabimet, t'i drejtosh punët që të kanë dalë nga kontrolli, të rregullosh gjendjen.

Në qoftë se ju bie në sy një sistem që, me drejtësi, rregullon marrëdhëniet ndërmjet njerëzve, në qoftë se ka një mëshirë e butësi që i lidh zemrat e tyre, apo nëse në një vend të pasurit me mëshirë vrapojnë në ndihmë ndaj të varfërve, të fuqishmit mbrojnë të dobëtët, të shëndetshmit ndihmojnë të sëmurët, të pasurit kujdesen për jetimët e vejushat pa kurrfarë interesi, ta dini se këto cilësi janë të Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*) dhe të atyre që ndjekin rrugën e tij.

Jeta e Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*) është e jashtëzakonshme; vlerat më të larta të etikës dhe moralit janë të tubuara tek ai. Për çdo gjë që kërkohet dhe është e nevojshme për njerëzit, gjendet shembull në jetën e tij shembullore. Ai është pikë orientimi për edukimin e njerëzve në mbarë rruzullin tokësor. Ai



ndriçon rrugën e atyre që e kërkojnë atë. Ai e ndriçon çdokënd që dëshiron ta gjejë lumturinë. Ai është i vetmi udhërrëfyes i njerëzisë.

Edhe pse Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*) është ndarë nga kjo jetë, këshillat dhe porositë e tij vazhduan, vazhdojnë dhe do të vazhdojnë deri në fund të kësaj jete. Përkujtim i Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*) do të thotë zbatim i Kur'anit dhe i traditës profetike. Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*) nuk duhet përkujtuar vetëm në muajin Rebiul Evel. Ai duhet përkujtuar çdo ditë, çdo orë e në çdo hap që bëjmë, sepse porositë e tij vërtet janë recetë për shërimin e shpirtit e të zemrës, për arritjen e lumturisë së vërtetë në të dy jetët.

Allahu i Lartësuar thotë në Kur'an: *"Thuaj: 'Nëse e doni Allahun, atëherë më ndiqni, që Allahu t'ju dojë dhe t'jua falë gjynahet tua, se Allahu është Ai që fal shumë, mëshiron shumë'".*¹⁰⁵

105 Sure "Al Imran", ajeti 31.



POROSI TË PROFETIT MUHAMED

(Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!)

PËR IMAM ALIUN *(Paqja qoftë mbi të!)*

Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit. Falënderimet i takojnë Allahut të Madhëruar! Paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi Profetin Muhamed, mbi familjen e tij të pastër dhe mbi shokët e tij të zgjedhur!

Es Selamu alejkum ue rahmetullahi ue berakatuhu!

Paqja, mëshira dhe begatitë e Allahut qofshin mbi ju!

Allahu i Madhëruar thotë: “E Allahut është gjithçka që gjendet në qiej dhe në Tokë. Ne i kemi porositur ata që u është shpallur Libri para jush dhe juve: ‘Frikësojuni Allahut! Nëse mohoni, dini se Allahut i përket gjithçka që gjendet në qiej dhe në Tokë. Allahu është i Vetëmjaftueshëm dhe i Denjë për çdo lavdërim’”.¹⁰⁶

106 Sure “En-Nisa”, ajeti 131.



Kuptimi i porosisë është që të nxisësh të tjerët në bërjen e të mirave dhe t'i paralajmërosh ata nga e keqja. Në ajetin e lartpërmendur, lexojmë se Allahu i Madhëruar na porosit të gjithëve, që në këtë jetë të jemi të devotshëm. Sigurisht që porosia e Allahut për devotshmëri është porosia më madhështore dhe themeli i të gjitha të mirave, sepse devotshmëria është diga më e fortë në përballjen me furtunat e të keqes. Padyshim që porosia ka ndikim të madh edukativ. Nëpërmjet porosisë së drejtë arrihet udhëzimi, lumturia dhe shpëtimi në të dyja jetët.

Në Kur'anin e shenjtë ka ajete që tregojnë se profetët e Allahut kanë porositur familjet e tyre dhe popujt e tyre. Prej tyre është ajeti: **“Ibrahimi ua dha këtë porosi fëmijëve të tij; po ashtu edhe Jakubi: “O bijtë e mi! Pa dyshim, Allahu ka zgjedhur për ju fenë e vërtetë, prandaj mos vdisni ndryshe veçse duke qenë myslimanë të nënshtuar ndaj Atij!”¹⁰⁷**

Mirëpo, ndër të gjithë të dërguarit, Allahu i Madhëruar e pajisi vulën e të dërguarve, Profetin Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*) me shumë veçanti. Ndër to ishte edhe bukuria e fjalës dhe ëmbëlsia e saj. Ai përdorte fjalë të pakta e fjali të shkurtra, por shumë domethënëse. Ky është shkaku që porositë e Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi*

107 Sure “El-Bekare”, ajeti 132.



familjen e tij!) edhe sot e kësaj dite vazhdojnë të shkruhen me germa të arta dhe në shumë gjuhë të botës.

Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*) nuk fliste sipas qejfit dhe dëshirës së tij, por çdo thënie e tij ishte shpallje e shpallur. Në Kur'an thuhet: **"Ai nuk flet sipas qejfit të vet, por ajo (që thotë) është vetëm shpallje hyjnore, që i vjen atij. Atë ia ka mësuar atij një (engjëll) shumë i fuqishëm (Xhebraili), mendjelartë, që iu paraqit qartë, në horizontin më të lartë".**¹⁰⁸

Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*) gjithmonë i porosiste shokët e tij. Prej porosive mjaft domethënëse janë porositë për Prijësin e besimtarëve, Imam Aliun (*Paqja qoftë mbi të!*). Më poshtë po përmendim disa prej atyre porosive.

Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*) i ka thënë Imam Aliut (*Paqja qoftë mbi të!*):

"O Ali! Po të jap disa porosi. Nëse i ruan porositë e mia, do të jesh në mirësi.

○ Besimtari ka tri shenja: namazin, zekatin dhe agjërimin.

108 Sure "Nexhm", ajetet 3-7.



○ I padrejti ka tri shenja: i lajkaton njerëzit me gënjeshtër, kur i sheh; i përgojon, kur nuk janë të pranishëm dhe gëzohet për fatkeqësinë e tjetrit.

○ Për burrin ka tri shenja: është aktiv, kur ndodhet me njerëzit; përtac, kur është vetëm dhe do që të lavdërohet në të gjitha çështjet e tij.

○ Lexoje suren “Ja Sin”, sepse në të ka dhjetë të mira: nëse e lexon i urituri, ngopet; nëse e lexon i eturi, i shuhet etja; nëse e lexon i zhveshuri, Allahu Madhëruar e vesh atë; nëse e lexon beqari, martohet; nëse e lexon i frikësuar, Allahu e siguron; nëse e lexon i sëmuri, shërohet; nëse e lexon i burgosuri, Allahu e shpëton nga burgu; nëse e lexon udhëtari, Allahu i Madhëruar e ndihmon në udhëtim; nëse i lexohet njeriut në prag të vdekjes, atij i lehtësohen momentet e daljes së shpirtit, ndëshkimi dhe dënimi; nëse e lexon i humburi, Allahu e udhëzon; nëse e lexon pronari i diçkaje të humbur, ai e gjen atë.

○ Hipokriti ka tri shenja: kur flet, gënjen; kur i besohet diçka, tradhton dhe, kur premtion, nuk e zbaton premtimin.

○ Nëse dikush të bën padrejtësi, mos iu anko askujt dhe mos ia thuaj askujt prej njerëzve, sepse, nëse ua thua, ti i njeh ata me gjynahun e tij dhe bëhesh i njëjtë me atë (të padrejtin).



○ Ai që ia fal vëllait të tij padrejtësinë e vogël apo të madhe, do të ketë shpërblim tek Allahu dhe do të jetë prej të afërmve që hyjnë të kënaqur në Xhenet.

○ Bereqeti ndodhet në katër cilësi: 1-Mos shiko ato që janë në duart e të tjerëve. 2- Mos u mbështet te krijesa. 3-Mendo mirë për Allahun. 4- Mos e mendo të shumtë punën tënde.

○ I ligu ka katër cilësi: pangopësia e syrit, ashpërsia e zemrës, shpresat e largëta dhe dashuria e madhe për këtë jetë.

○ I kënaquri ka katër cilësi: nuk gëzohet me pasurinë, nuk ka frikë, nuk interesohet për furnizimin dhe nuk zemërohet për këtë jetë.

○ Idioti ka tri cilësi: grindet me atë që është më lart se ai, është kryeneç dhe mendjemadh ndaj atij që është më poshtë se ai dhe e grumbullon pasurinë me haram (të ndaluara).

○ I keqi ka tri shenja: heziton në kohën e namazit, flet shumë, por nuk e përmend Allahun dhe ka dëshirë të pakët ndaj bindjes së Allahut.

○ I lumturi ka tri cilësi: vërtetësinë e thënies në brendinë e tij, para se t'i kërkohet që ai ta thotë, dëshiron



shumë përmendjen e Allahut dhe kujdeset shumë për bindjen ndaj Allahut.

○ Mburracaku ka gjashtë cilësi: kur falet me njerëzit, e zgjat rukunë dhe suxhudin; i shkurton, kur është vetëm; është modest ndaj njerëzve; mendjemadh ndaj familjes së tij; thotë fjalë të këqija dhe i përmend shumë të këqijat e njerëzve.

○ Bamirësi ka katër cilësi: e brendshmja e tij është më e mirë se sa e jashtmeja e tij, i bën mirë atij që i bën keq, jep në fshehtësi dhe mbulon të këqijat e njerëzve.

○ Nëse dikush të lavdëron në sy, thuaj: “Falënderoj Allahun që më bëri prej atyre që më mendojnë të mirë. O Zot më fal mua atë që nuk e dinë dhe mos më qorto për atë që thonë për mua.”

Vërtet, eulijatë (të dashurit) e Allahut të Madhëruar e fitojnë mëshirën e gjerë të Allahut dhe faljen e Tij vetëm me adhurimin e shumtë, me asketizmin, me shpirtmirësinë, me nënvleftësimin e dynjasë dhe me braktisjen e saj.

Në portën e Xhenetit është shkruar: “Unë jam i ndaluar për çdo koprrac, mburracak dhe për atë që sillet keq me prindërit e tij”.



Kur Allahu i Madhëruar e krijoi Xhenetin, Xheneti i tha: “O Zoti im. Për kë më ke krijuar?”

-Të krijova për çdo bujar të devotshëm.

- Jam i kënaqur për këtë, - tha Xheneti. - O Zoti im! Kush e kundërshton egon e vet, unë (Xheneti) do të jem vendbanimi i tij dhe kush i bindet egos së vet, zjarri do të jetë vendbanimi i tij.

Kur Allahu e krijoi zjarrin, zjarri i tha: “O Zoti im. Për kë më ke krijuar?” Allahu i Madhëruar i tha: “Të krijova ty për çdo koprrac mendjemadh”. Zjarri i tha: “E prano krijimin”.

Nderojë fqinjin tënd, edhe nëse është i pafe.

Kush ushqehet me hallall, ai pastron besimin e tij, i zbutet zemra, i lotojnë sytë nga frika ndaj Allahut dhe nuk gjendet pengesë për lutjen e tij.

Ai që ushqehet me ushqime të dyshuara, atij i dyshohet feja (besimi) dhe i bën padrejtësi zemrës së tij.

Nëse prijësi nuk është i drejtë, ai është si reja që s’ka shi. Nëse i pasuri nuk është bujar, ai është si pema pa fruta. Nëse dijetari nuk është i devotshëm, ai është si qiri që djeg veten e tij për interes të tjerëve. Nëse i varfëri nuk është i durueshëm, ai është si toka pa të mbjella. Nëse i riu nuk



është pendues, ai është si pusi pa ujë. Nëse femra nuk ka turp, ajo është si ushqimi që s'ka kripë. Nëse prijësi është i drejtë, ai do të ketë shpërblimin e Ismailit. Nëse i pasuri është bujar, ai do të ketë shpërblimin e Ibrahimit. Nëse i varfëri është i durueshëm, ai do të ketë shpërblimin e Ejubit. Nëse femra do të jetë e turpshme, ajo do të ketë shpërblimin e Merjemes. Nëse dijetari është i devotshëm, ai do të ketë shpërblimin e Jakubit.

Namazi është shtylla e fesë. Vërtet, Allahu dhe melekët bëjnë salavat për Profetin dhe bëjnë salavat për atë që fal namazin. Dy rekate namaz natën janë më të mira se njëmijë rekate ditën.

Namazi i natës është dritë për atë që e fal në këtë jetë dhe në Jetën Tjetër. Në Ditën e Kiametit namazfalësi i namazit të natës do të tubohet i hipur mbi një deve prej deveve të Xhenetit dhe në të djathtën e tij do të ketë pafajësinë e shpëtimit prej zjarrit dhe sigurinë prej dënimit të Mposhtësit (Allahut).

Ai që fal namazin e natës, për çdo rekat do të ketë një pallat, për çdo sexhde hyri. Prej nderimit të falësit të namazit të natës është se Allahu e do atë dhe e bën të dashur te njerëzit, i jep shëndet dhe ia zgjeron riskun.

Ai që ecën për të falur namazin me xhemat, do t'i shkruhet shpërblimi i një Haxhi. Ai që ecën për të falur



nafile (namaz vullnetar), do t'i shkruhet shpërblimi i një Umreje.

Ji dijetar, ose nxënës, ose dëgjues dhe mos ji i katërt. Imami i tha: “Kush është i katërti?” Profeti iu përgjigj: “Është ai që as nuk di, as nuk mëson, as nuk u mëson dhe as nuk e dëgjon dijen”.

Adhuresi i paditur është si ai që mat ujin e detit dhe nuk e di tepricën nga mangësia e tij.

Kërkoje diturinë, qoftë edhe në Kinë, sepse s'ka gjë më të dashur tek Allahu se sa dijetari apo nxënësi, apo dëgjuesi i dijes.

Nderojë mikun që viziton për hir të Allahut, sepse ai që e nderon mikun e Allahut, atë e nderon Allahu. Kush e urren mikun e Allahut, atë e urren Allahu. Nëse miku shkon në një shtëpi, me të shkon edhe risku i tij. Kur largohet, largohen edhe mëkatet e familjes dhe hidhen në det.

Kujdesu për fqinjin, edhe sikur të jetë jobesimtar. Ji i dashur dhe zemërbutë me fqinjin. Dije se ai që ka smirë për fqinjin e tij, Allahu ia mbyll atij jetën në të kotë dhe ia merr atij pasurinë.

Mjerë ti dhe smira, sepse smira i djeg të mirat, ashtu siç i djeg zjarri drutë.



Mjerë ti dhe gënjeshtër, sepse ajo është prej moralit të hipokritëve. Mjerë ti dhe thashethemet, sepse Allahu ia ka ndaluar Xhenetin koprracit, atij që merret me thashetheme, mburracakut, atij që sillet keq me prindërit, pirësit të alkoolit, grave të shthurura, atij që kryen marrëdhënie me kafshët, atij që i bën keq fqinjit të vet. Të gjithë këta nuk hyjnë në Xhenet, vetëm nëse pendohen dhe kërkojnë falje.

Nderojë të moshuarin dhe mëshirojë të voglin. Bëhu për të huajin si vëlla dhe bëhu për jetimin si baba i dhembshëm. Nëse je i tillë, Allahu do të të shkruajë ty për çdo hap njëmijë të mira dhe do të të fshijë njëmijë të këqija dhe do të të japë për çdo të mirë një pallat në Xhenet.

Ulu me të varfrit, që të të lartësohet pozita tek Allahu. Ai që nderon të pasurin dhe poshtëron të varfrin, në qiej e në tokë, quhet armik i Allahut.

Agjëroi ditët e bardha, sepse ato janë si agjërimi i një viti të plotë. Kushdo që agjëron Ramazanin dhe e vazhdon me gjashtë ditë nga Shevali, është njësoj sikur ka agjëruar gjithë kohët.

Mbuloji të këqijat e njerëzve, që Allahu të t'i mbulojë të këqijat e tua. Ai që ua mbulon të këqijat njerëzve, Allahu do t'i zbresë atij shtatëdhjetë mëshira dhe do t'i hedhë shtatëdhjetë bereqete mbi pasurinë e tij.



Thuaje të vërtetën, qoftë edhe kundër vetes tënde dhe jep sadaka, qoftë edhe një hurmë, sepse sadakaja largon të këqijat.

Allahu është i zemëruar ndaj tri personave: Ai që fle i ngopur dhe e di që fqinji i tij është i uritur. Ai që e rreh shërbyesin (skllavin) e tij pa bërë mëkat dhe ai që e refuzon dhuratën e shokut apo të mikut të tij, të cilën nuk ia ka kërkuar.

Mos ji kokëfortë dhe mos u shoqëro me kokëfortët. Mos ji koprrac dhe mos u shoqëro me koprracët, sepse koprracia është një pemë në Xhehenem. Kushdo që kapet pas një dege të saj, hyn në zjarr.

Koprraci është larg Allahut, larg mëshirës së Tij, larg Xhenetit dhe afër zjarrit.

Zemërgjeri është afër Allahut, afër mëshirës së Tij dhe larg dënimit të Tij.

Kënaqu me pak nga dynjaja dhe jep, kur ke pak, sepse Allahu e begaton atë. Ai që vepron kështu, Allahu do ta ringjallë me profetët në Ditën e Kiametit.

Pakësoje ushqimin, që të jesh i shëndetshëm. Ki kujdes nga ngopja, sepse ajo trashëgon ashpërsi të zemrës.



Mos ia thuaj sekretin tënd as njerëzve dhe as grave, sepse ato nuk mbajnë sekrete. Mos i beso shokut, derisa ta provosh atë.

Kur të vijë koha e namazit, përgatitu për atë dhe kujdesu që djalli mos të të punësojë ndaj tij.

Mos u shoqëro me pijanecin e alkoolit, sepse është i mallkuar ai që e shet atë. As mos u shoqëro me atë që mban alkool, sepse ai në qiell quhet armik i Allahut. I tillë është edhe ushqyesi me kamatë.

Mos e mallko myslimanin dhe as kafshën, sepse mallkimi të kthehet ty.

Gjumi i tepërt sjell varfëri dhe trashëgon pendim.

Kush gëzohet me ëmbëlsinë e mëkatit, do të qajë, kur të provojë hidhësinë e dënimit.

Kush gëzohet me padrejtësinë që i bën fqinjit të tij, do të qajë për ngushtinë e varrit.

Kush gëzohet me ëmbëlsinë e dynjasë, do të qajë kur t'i jepet libri (i veprave) nga e majta e tij.

Xhiahadi më i madh është ai se, kur njeriu zgjohet, nuk mendon t'i bëjë padrejtësi askujt.



Allahu ia ka ndaluar Xhenetin çdo imorali, atij që flet fjalë të këqija e të ndyta dhe çdo njeriu që nuk interesohet për ato që ai thotë e as për ato që atij i thonë.

Mos bëj shumë shaka, sepse të ikën madhështia. Mos gënje, sepse të ikën drita (nuri) jote. Bëj kujdes nga mërzia dhe nga dembelizmi, sepse, kur mërzitesh, nuk duron ndaj të vërtetës dhe, kur dembelosesh, nuk e vepron të vërtetën.

Ai njeri nga gjuha e të cilit njerëzit kanë frikë, ai është prej banorëve të zjarrit.

Pirësi i alkoolit është si adhuruesi i idhujve.

Njeri i keq është ai që njerëzit i bëjnë mirë atij për t'u ruajtur nga e keqja e tij.

Njeriu më i keq është ai që shet Ahiretin e tij për dynjanë e tij. Më i keq se ky, është ai që shet Ahiretin e tij për dynjanë e një tjetri".

Sa shumë kemi nevojë për këto porosi! Sidomos në këtë kohë, në të cilën njerëzit janë të zhytur në botën e materializmit dhe e kanë harruar botën shpirtërore!

Sigurisht, këto porosi të Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*) janë të vlefshme për çdo kohë dhe për çdo vend.



Në Kur'anin e shenjtë lexojmë: "...**Pra, jepu lajme të gëzueshme robëve të Mi, të cilët, pasi i dëgjojnë fjalët (që u thuhet), ndjekin atë që është më e mira prej tyre. Këta janë ata që Allahu i ka udhëzuar në rrugë të drejtë; këta janë mendarët**".¹⁰⁹

Padyshim që fjala më e mirë dhe porosia më e përkryer janë ato të Allahut, të profetëve në përgjithësi dhe të Profetit Muhamed në veçanti, si dhe ato të eulijave (të dashurve) të Allahut. Allahu i Madhëruar na bëftë prej atyre që i dëgjojnë thëniet dhe porositë dobiprurëse dhe i zbatojnë ato në jetën e tyre!

109 Sure "Ez-Zumer", ajetet 17-18.



TREGIME TË NDRYSHME

XHYBJA E PROFETIT MUHAMED

(Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!)

Transmetohet se Profetit Muhamed (Paqja e bekimi e Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!) i dhuruan një xhybe dhe atë e ruante zonja Fatime Zehra (Paqja qoftë mbi të!). Një ditë prej ditësh, një nevojtar trokiti te dera e shtëpisë së Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*) dhe i kërkoi atij sadaka. Profeti Muhamed (Paqja e bekimi e Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!) i tha Fatimes: “Oj Fatime. Jepja nevojtarit xhyben”. Nevojтари e mori dhe u gëzua shumë. Pastaj shkoi në treg dhe filloi të thërriste: “Kush e ble xhyben e Dërguarit të Allahut?”

Njerëzit u grumbulluan rreth tij dhe të gjithë donin ta blinin xhyben. Thirrjen e dëgjoi një i verbër dhe i tha shërbyesit të tij: “Shko dhe ma sill xhyben, sado e shtrenjtë që të jetë. Nëse e bën këtë punë, ti je i lirë”. Shërbyesi ia solli



xhyben. I verbëri e mori dhe tha: “O Zoti im! Për hak të Profetit Tënd, për hak të bereqeteve të xhybes së tij të pastër, që ndodhet në duart e mia, ma kthe shikimin!” Pas pak çastesh atij iu kthye shikimi dhe u gëzua shumë. Menjëherë shkoi te i Dërguari i Allahut dhe i tha: “O i Dërguari i Allahut, mua m’u kthye shikimi. Urdhëro këtë xhybe, e ke dhuratë nga unë”. Burri i tregoi se çfarë kishte ndodhur dhe Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*) qeshi. Pastaj i tha Fatimes: “Oj Fatime. Shikoje këtë xhybe. Ajo e pasuroi një të varfër. E shëroi një të sëmurë dhe e lëroi një rob dhe pastaj u kthye përsëri te ne”.

I lartësuar dhe i lavdëruar je Ti o Allah, që na ke nderuar, na ke fisnikëruar dhe na ke bekuar me dërgimin e Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*).

O Zot, bekoje Muhamedin dhe familjen e Muhamedit, njësoj siç bekove Ibrahimin dhe familjen e Ibrahimit. Vërtet, Ti je Falënderues dhe i Lartë. Mirësoje Muhamedin dhe familjen e Muhamedit, siç mirësove Ibrahimin dhe familjen e Ibrahimit. Vërtet, Ti je Falënderues dhe i Lartë.



PËRSE PROFETI MUHAMED

(Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!)

E SHKUNDTE TRI HERË DYSHEKUN PARA SE TE FLINTE?

Shikojeni këtë insekt në foto. Ky insekt fle me ty çdo natë. Fotoja e tij është e zmadhuar disa herë me mikroskop elektronik. Ai jeton në dyshek, në batanije, në jastëk etj... Rruga më e mirë për ta larguar këtë insekt, është vendosja e dyshekut në diell, sepse ai është i ndjeshëm ndaj dritës së diellit. Duhet ditur se ky insekt nuk ndikohet nga larja. Shkundja e dyshekut tri herë para fjetjes, është një traditë që shumë njerëz e kanë braktisur. Kjo shkundje ka mrekulli shkencore. Shkencëtarët dhe dijetarët e nderuar kanë konstatuar se, kur njeriu fle në shtratin e tij, qelizat që vdesin nga trupi i tij, bien në dyshek. Kur njeriu zgjohet, këto qeliza të vdekura mbesin në dyshek. Kur fle përsëri, vdesin përsëri qeliza të tjera dhe këto qeliza oksidohen dhe hyjnë në trupin e njeriut. Ato shkaktajnë shumë sëmundje (Allahu na ruajttë!). Këto qeliza nuk shihen veçse me mikroskop. Përfundimorët janë përpjekur ta zgjidhin këtë problem. Ata



bënë larjen e dyshekëve me lëndë pastruese, por pa rezultat. Ata përdorën të gjitha llojet e pastrimit, por këto qeliza nuk u zhdukën. Një dietar përëndimor e shkundi tre herë me dorën e tij dhe pa që qelizat u zhdukën. Ai u gëzua, sepse zbuloi se, duke e shkundur tri herë dyshekun, qelizat e vdekura zhduken nga ai. Një mysliman i tha: “Këtë gjë e ka thënë më parë Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*): ‘Kur të flini në shtratin tuaj, shkundeni tri herë dyshekun dhe mbulesën e tij, sepse nuk i dihet se çfarë është lënë më parë në të’”.

Mirëpo duhet të dihet se kjo çështje përmban mirësi më të mëdha se kjo që përmendëm, sepse, nëse Allahu i Madhëruar dhe Profeti i Tij i nderuar na ndalojnë nga diçka, këtë e bëjnë, sepse në të gjendet dëm për shëndetin tonë. Allahu i Madhëruar thotë: **“Vërtet, Allahu është i Gjithëmëshirshëm për ju”**. Gjithashtu, thotë: **“Ne nuk të kemi dërguar ty veçse mëshirë për mbarë botët”**.



A QESH XHEBRAILI (Paqja qoftë mbi të!)?

Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*) e ka pyetur Xhebrailin: “A qesh Xhebraili?”

- Po, - i tha Xhebraili.

- Kur? - e pyeti Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*).

- Kur lind njeriu e deri në vdekje dhe ai kërkon diçka që nuk është krijuar në dynja, - iu përgjigj Xhebraili.

Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*) u habit dhe e pyeti: “Cila është ajo gjë, që njeriu e kërkon dhe që nuk është krijuar në dynja?”

- Rehatia, - i tha Xhebraili, - sepse Allahu nuk e ka krijuar rehatinë në dynja, por e ka krijuar në Ahiret. Për këtë, njeriu e kërkon gjithmonë rehatinë. Fëmija thotë se kur do të rritem. I riu thotë, ‘ah, sikur të kthehem përsëri fëmijë’. I moshuari thotë, ‘ah, sikur të kthehej rinia përsëri’. E martuara thotë, ‘ah, sikur të kthehem beqare’. Beqarja uron



të martohet. Ai që nuk ka fëmijë, thotë, 'ah, sikur të kisha një fëmijë'. Ai që ka fëmijë dhe mërzhitet prej tyre thotë, 'ah, sikur të mos i kisha lindur fëmijët'. Ai që është martuar me një grua, do të martohet me të tjera, në kërkim të rehatisë. Të gjithë e kërkojnë rehatinë, por në këtë dynja rehatia nuk gjendet".

Ne duhet të kënaqemi me atë që na ka caktuar Allahu dhe ta falënderojmë Atë për këtë caktim. Duhet ta dimë se rehatia jonë gjendet në adhurimin e Allahut dhe në bindjen ndaj Tij, me qëllim që të jemi të rehatuar në Jetën Tjetër (Ahiret).



ZIJARETI I PROFETIT MUHAMED

(Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!)

Bismilahi Rrahmani Rrahim!

Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit,
Mëshirëplotit!

All'Ilahumme Sal'li ala Muhammedin ue ali
Muhammedin!

O Allah! Bekoje Muhamedin dhe familjen e Muhamedit!

Paqja qoftë mbi ty, o i Dërguari i Allahut!

Paqja, mëshira dhe begatitë e Allahut qofshin mbi të
Dërguarin e Allahut; Besnikun e Allahut ndaj Shpalljes së
Tij dhe të vendosurin ndaj urdhrit të Tij; Përmbyllësi i atyre
para tij dhe çlirimtari për atë që do të vijë, ngadhënjyesi (më
i larti) ndaj të gjithë atyre!

Paqja qoftë mbi pronarin e qetësisë!

Paqja qoftë mbi të varrosurin në Medinë!



Paqja qoftë mbi të ndihmuarin dhe të përkrahurin!

Paqja qoftë mbi të Dërguarin e udhëzuar!

Paqja qoftë mbi babain e Kasemit, Muhamedin, të birin e Abdullahut!

Paqja, mëshira dhe mirësitë e Allahut qofshin mbi të!

Paqja qoftë mbi ty, o i Dërguari i Allahut!

Paqja qoftë mbi gjyshin tënd, Abdul Mutalibin!

Paqja qoftë mbi babain tënd, Abdullahun!

Paqja qoftë mbi nënën tënde, Eminen, vajzën e Uehebit!

Paqja qoftë mbi ty dhe mbi punëmirët, prej xhaxhallarëve të tu!

Paqja qoftë mbi ty dhe mbi xhaxhain dhe kujdestarin tënd, Ebu Talibin!

Paqja qoftë mbi ty dhe mbi hallat e tua!

Paqja qoftë mbi ty, mbi djemtë e tu dhe vajzat e tua!

Paqja qoftë mbi ty dhe mbi punëmirat, prej bashkëshorteve të tua!



Paqja, mëshira dhe begatitë e Allahut qofshin mbi të gjithë ata!

Paqja, mëshira dhe begatitë e Allahut qofshin mbi zonjën tonë, Hadixhetul Kubra, nëna e besimtarëve!

Paqja, mëshira dhe begatitë e Allahut qofshin mbi të gjithë ata!



DUA (Lutje)

O Allah! Bekoje Muhamedin dhe familjen e Muhamedit, zotëria i falënderuesve!

O Allah! Bekoje Muhamedin dhe familjen e Muhamedit, zotëria i të kujdesshmëve!

O Allah! Bekoje Muhamedin dhe familjen e Muhamedit, zotëria i përkujtuesve!

O Allah! Bekoje Muhamedin dhe familjen e Muhamedit, zotëria i intelektualëve!

O Allah! Bekoje Muhamedin dhe familjen e Muhamedit, zotëria i punëmirëve!

O Allah! Bekoje Muhamedin dhe familjen e Muhamedit, zotëria i fisnikëve!

O Allah! Bekoje Muhamedin dhe familjen e Muhamedit, zotëria i paralajmëruesve!

O Allah! Bekoje Muhamedin dhe familjen e Muhamedit, zotëria i përgëzuesve!



O Allah! Bekoje Muhamedin dhe familjen e Muhamedit, zotëria i të mirëve!

O Allah! Bekoje Muhamedin dhe familjen e Muhamedit, zotëria i Profetëve!

O Allah! Bekoje Muhamedin dhe familjen e Muhamedit, zotëria i të gjitha botëve!

Es selamu alejke ja Resulallah!

Paqja qoftë mbi ty, o i Dërguari i Allahut!

Allahu na dhuroftë shefatin e Profetit dhe të Ehli Bejtit të tij të pastër e të nderuar!



Përmbajtja

Profeti Muhamed, Profeti i paqes dhe i dashurisë.....	5
PROFETI MUHAMED (<i>Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!</i>) NË KUR' AN.....	16
Metoda e thirrjes së Profetit Muhamed (<i>Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!</i>) sipas Kur'anit.....	25
Morali i Profetit Muhamed (<i>Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!</i>) në thirrje.....	29
Profeti Muhamed (<i>Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!</i>), Kur'ani folës.....	33
Të qenit njeri.....	35
Si përballej Profeti (<i>Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!</i>) me sfidat?.....	38
Profeti i pashkolluar mësoi dhe edukoi popuj.....	41
Ndërtimi i xhamisë.....	48
Vëllazërimi.....	49
Profeti Muhamed (<i>Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!</i>), i Dërguari për mbarë njerëzimin.....	57



“Vërtet, tek i Dërguari i Allahut ju keni shembullin më të lartë”	69
Kush është Profeti Muhamed (<i>Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!</i>)?.....	71
Profeti Muhamed (<i>Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!</i>) mëshirë për krijesat.....	74
Ditëlindja e Profetit Muhamed - dita e unitetit islam.....	79
Porosi të Profetit Muhamed (<i>Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!</i>) për Imam Aliun (<i>Paqja qoftë mbi të!</i>).....	84
TREGIME TË NDRYSHME.....	98
Xhybja e Profetit Muhamed (<i>Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!</i>).....	98
Përse Profeti Muhamed (<i>Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!</i>) e shkundte tri herë dyshekun para se te flinte?.....	100
A qesh Xhebraili (<i>Paqja qoftë mbi të!</i>)?.....	102
Zijareti i Profetit Muhamed (<i>Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!</i>).....	104



اسم الكتاب: النبي محمد صلى الله عليه وآله، نبي السلام والمحبة

المؤلف: الحاج الشيخ ولنت مريا

التصحيح الأدبي: بريدنا كولا

التصحيح اللغوي: ويولساكاراي

الاخراج النهائي: صبريه فزا

الغلاف: إسرا مريا

ناشر: جمعية النسيم - تيرانا - ألبانيا 2021